



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
“Shkenca Kompjuterike”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Bedër”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Miranda Harizaj

2. Dr. Adisa Dabërdini

Gusht /2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" ofruar nga institucioni i arsimit të lartë Kolegji Universitar "Bedër"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Bedër"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Kompjuterike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 329, dt. 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023:	6/7 Bazuar në ngarkesën mësimore rezulton: 73 % PAE / 27% PAK
18	Numri i studentëve 2021-2023:	19 studentë (për një cikël të plotë studimi)
19	Komente / të tjera:	-

2

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar Bedër ka filluar aktivitetin akademik në vitin 2012, pas liqensimit të tij me VKM Nr. 286, datë 6.04.2011. Me Urdhër Nr. 223, datë 4.06.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës është realizuar akreditimi i parë institucional. Institucioni riorganizohet në dy njësi kryesore, me urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 200, datë 03.07.2020, përkatësisht:

1. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë;
2. Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit;

IAL ka zhvilluar procesin e fundit të vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.57, datë 16.12.2021 që e akrediton institucionin për 5 vite akademike.

Me urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 329, datë 17.09.2021, hapet programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", pjesë e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit. Aktualisht programi ka hyrë në procesin e akreditimit. Kohëzgjatja e tij normale është 2 vite dhe numri krediteve të tij është 120 ECTS.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", ofruar nga Kolegji Universitar Bedër. Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga Kolegji Universitar Bedër.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Ky raport është përgatitur nga grupi i ekspertëve të jashtëm të përcaktuar nga ASCAL në përputhje me Manualin 2017. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Dr. Miranda Harizaj dhe Dr. Adisa Dabërdini. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Endra Velaj.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Kolegji Universitar Bedër, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", nga Kolegji Universitar Bedër, e përbërë nga 181 dokumenta në total. Ekspertët sipas një axhende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit kanë realizuar vizitat në datë 20-21 Mars 2023, në institucion sipas veprimtarive të parashikuara në axhendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët. Grupi i ekspertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kriterëve të standarteve shtetërore të cilësisë nga institucioni i arsimit të lartë Kolegji Universitar "Bedër".

Më datë 17.07.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 81/22 Prot., datë 17.07.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 21.07.2023, dhe me shkresë zyrtare Nr. 35/4 Prot., datë 21.07.2023, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.2, Kriteri 1 dhe konkluzione,

GVB Koment:

Kolegji Universitar "Beder" dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike në vazhdimësi dhe herë pas here kanë shpallur procedurat për rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë me tituj në këtë departament. Vetëm gjatë vitit akademik 2022-2023 janë rekrutuar 4 staf akademik me kohë të plote. 1 me gradën Prof. Dr dhe 3 me titull MSc. (Evidence Shtese 1 procedure shpallje vendi vakant per staf). Edhe për vitin akademik 2023-2024 departamenti ka shpallur vend vakant për staf me gradat Prot:Dr, Prof.Asoc.Dr ose Dr. Vetë përmirësimi i raportit të ngarkesës nga njëri vit në vitin tjetër akademik përkatësisht nga viti akademik 2021- 2022 në atë 2022-2023 PAE: PAK (nga 60%-40% në 73%-27%) dëshmon për një ndërgjegjësim të rritur nga ana e institucionit për përmirësimin e këtij raporti dhe angazhimin e më shumë anëtarëve të stafit efektiv me tituj në mësimdhënie. **GVJ:** Për sa më sipër, pasi vlerësoi dhe dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion, si dhe bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, evidenton se konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë dhe mbështeten dhe nga komenti/sqarimi i dhënë nga institucioni. **Raporti në këtë pikë nuk ka ndryshim.**

2. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.3, Kriteri 4 dhe konkluzione,

GVB Koment:

Emrat përkatës të titullarëve të lëndëve dhe të asistentëve të tyre konfigurohen në mënyrë të përvitshme në dokumentin e ngarkesës mësimore, si dhe në sistemin BIS dhe në syllabuse. Ndërkohë temat e detyrave dhe projekteve të kursit janë konsideruar shpeshherë elemente fleksibel, dinamike dhe që variojnë edhe në përputhje me bashkëbisedimet që kryhen nga titullarët e lëndëve me studentët çdo fillim viti në kuadër të prezantimit të lëndës.

GVJ: Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë dhe mbështeten dhe nga komentit/sqarimi i dhënë nga institucioni. **Raporti në këtë pikë nuk ka ndryshim.**

3. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.7, Kriteri 1 dhe konkluzione,

GVB Koment:

Ka një shtim të ndjeshëm të marrëveshjeve institucionale nga viti në vit qofshin këto në formën e MOU me IAL, institucione partnere apo industri, apo qofshin këto marrëveshje për exchange Erasmus Plus etj. Tendenca në rritje të dukshme të numrit të marrëveshjeve nga viti në vit është reflektuar edhe në një numër të shtuar aplikime projektesh të përbashkëta me universitetet apo institucionet partnerë p.sh. në vitin akademik 2022-2023 janë nënshkruar 7 marrëveshje të reja krahas 51 marrëveshjeve aktive ekzistente në formën e Memorandum Mirekuptimi dhe Erasmus+ (Evidenca Nr.25 Lista e Bashkepunimeve dhe MoU). Marrëveshjet e reja të lidhura gjenden në Evidencën Shtesë Nr. 2 Lista e Marrëveshjeve për 2022-2023. Gjithashtu janë hartuar 11 aplikime për projekte në bashkëpunim me institucionet e tjera. Duke qënë se tashme projektet janë multidisiplinore dhe në të shumtën e rasteve komponentët e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit janë pjesë integrale e tyre, Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka qënë pjesë thelbësore e hartimit të paketës së aplikimit për këto projekte, herë si njësi udhëheqëse Lead dhe herë si zbatues i aktiviteteve specifike.

GVJ: Për sa më sipër, pasi vlerësoi dhe dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga IAL, në vijim të dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion, evidenton se konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë. **Raporti në këtë pikë nuk ka ndryshim.**

4. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin III.4, kriteri 4 dhe Konkluzione,

GVB Koment

Ka një shtim të ndjeshëm të marrëveshjeve institucionale nga viti në vit qofshin këto në formën e MOU me IAL, institucione partnere apo industri, apo qofshin këto marrëveshje për exchange Erasmus Plus etj. Tendenca në rritje të dukshme të numrit të marrëveshjeve nga viti në vit është reflektuar edhe në një numër të shtuar aplikime projektesh të përbashkëta me universitetet apo institucionet partnerë p.sh. në vitin akademik 2022-2023 janë nënshkruar 7 marrëveshje të reja krahas 51 marrëveshjeve aktive ekzistente në formën e Memorandum Mirekuptimi dhe Erasmus+ (Evidenca Nr.25 Lista e Bashkepunimeve dhe MoU). Marrëveshjet e reja të lidhura gjenden në Evidencën Shtesë Nr. 2 Lista e Marrëveshjeve për 2022-2023. Gjithashtu janë hartuar 11 aplikime për projekte në bashkëpunim me institucionet e tjera. Duke qënë se tashme projektet janë multidisiplinore dhe në të shumtën e rasteve komponentët e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit

janë pjesë integrale e tyre, Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka qënë pjesë thelbësore e hartimit të paketës së aplikimit për këto projekte, herë si njësi udhëheqëse Lead dhe herë si zbatues i aktiviteteve specifike. .

GVJ: Për sa më sipër, pasi vlerësoi dhe dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga IAL, në vijim të dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion, evidenton se konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë. **Raporti në këtë pikë nuk ka ndryshim.**

5. Lidhur me komentit e institucionit për Standardin IV.2, Kriteri 3

GVB Koment

Kolegji Universitar Bedër dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike kanë marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme të fushës së teknologjisë së infomacionit dhe komunikimit. (Evidencë Shtesë 3. Lista e insitucioneve me të cilat Bedër ka marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave). Duke marrë në konsideratë dhe numrin e rregjistrimeve të studentëve në programin master departamenti nuk ka patur vështirësi në gjetjen e institucioneve për kryerjen e praktikave, por studentët janë përfshirë në praktikë më shumë se një herë dhe me shumë se pranë një institucioni edhe në formën e internshipeve krahas praktikës së detyruar. Gjithsesi KU Bedër dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike në vazhdim do punojnë për shtimin e marrëveshjeve me institucione të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Shtimi nga viti në vit i marrëveshjeve jep më shumë hapësira edhe për shtimin e marrëveshjeve me partnerë në fushën e teknologjisë dhe ofrimin e më shumë mundësive për studentët për kryerjen e praktikave profesionale.

GVJ: Për sa më sipër, pasi vlerësoi komentet dhe dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga IAL, në vijim të dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion, evidenton se konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë. **Raporti në këtë pikë nuk ka ndryshim.**

6. Lidhur me komentit e institucionit për Standardin IV.3, Kriteri 8 dhe Standardin II.4, Kriteri 5,

GVB Koment

Çdo vit Departamenti i Shkencave Kompjuterike përcjell pranë rektoratit listën me libra për përditësimin e literaturës në bazë të kërkesave të ardhura nga lektorët. Departamenti me kërkesën e tij dhe me mbështetjen e institucionit bën në mënyrë të përvitshme porosi për tekste-literaturë të viteve të fundit për tju shtuar fondit të bibliotekës dhe kjo prirje do të vazhdojë dhe në vijim me prioritet shtimin e fondit të literaturës fizike në fushën e shkencave kompjuterike.

GVJ: Për sa më sipër, pasi vlerësoi komentet dhe dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga IAL, në vijim të dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion, evidenton se konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë. **Raporti në këtë pikë nuk ka ndryshim.**

7. Lidhur me komentit e institucionit për Standardin IV.5, Kriteri 5,

GVB Koment

Bedër ka qënë në kategorine e "Kolegjeve Universitare" sipas ligjit për Arsimin e Lartë jo-Fitimprures, Bedër funksionon me një buxhet të centralizuar. Qëndrueshmeria financiare insitucionale në të njëjtën kohë nënkupton qëndrueshmeri financiare të programit të studimit në realizimin e procesit mësimor-kerkimor, mbarëvajtjen e programit dhe mbështetjen e studentëve pavarësisht numrit të studentëve të rregjistruar. Hapja e programeve master në çdo departament është pjesë e traditës së KUB që studentëve të tij ti ofrojë një alternativë serioze për të përballuar ndjekjen e programeve të ciklit të dytë duke përfituar secili prej tyre një zbritje të tarifës së shkollimit dhe sipas renditjes përfitojnë si vijon: i Pari 100%, i Dyti 80%, i Treti 60% dhe të Tjerët 50%.

Ashtu siç është konstatuar nëpërmjet Evidencave nr. 7, 11 dhe 65 përkatësisht evidenca për "Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (tabela 18)", "Pasqyra Financiare" dhe "Projektbuxheti", KUB ndër vite garanton qëndrueshmëri financiare ku përveç të ardhurave nga studentët një burim plotësues dhe garantor solidar është mbështetja e një rritje nga viti në vit ku donator të ndryshëm si TEMCC (The World Muslim Communities Council-Abu Dhabi) kanë marrëveshje për mbështetje të përvitshme për Kolegjin Universitar Bedër, projekte dhe grante ku është rritur prezenca në projekte të aplikuara dhe të fituara, si edhe të ardhura nga nënqira, ofrim shërbime trajnime etj. Kolegji Universitar Bedër është vazhdimisht në kërkim të fondeve nga shërbime, përveç të ardhurave nga studentët. Gjithashtu Kolegji Universitar Bedër në saj të kësaj marrëveshje me TWMCC, ka aplikuar për financimin e një laborator modern për fushën e IT-së (Evidencë Shtesë 4. Projekti për laboratorin që pritet të mbështetet nga Abu Dhabi)

GVJ: Për sa më sipër, pasi vlerësoi dhe dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga IAL, në vijim të dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion, evidenton se konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë. **Raporti në këtë pikë nuk ka ndryshim.**

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Shkenca Kompjuterike”**

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga KU “Bedër”, GVJ konstaton se në misionin e tij, KU “Bedër” përcakton përgatitjen e individëve të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë. Pjesë e misionit të KU “Bedër” është të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit. Në planin strategjik KU BEDËR synon krijimin dhe konsolidimin e një profili kombëtar dhe ndërkombëtar, duke mundësuar pranimin e studentëve nga trevat shqipfolëse në rajon dhe në diasporë. Gjithashtu, në misionin e tij Departamenti i Shkencave Kompjuterike (DSHK), që mbulon dhe programin Master i Shkencave në “Shkenca kompjuterike” është të përgatisë me njohuri teorike dhe praktike individë profesionistë e të kualifikuar të cilët do të kontribuojnë në fushën e shkencave kompjuterike me aftësitë e tyre analitike, shkencore, teknologjike, sociale dhe financiare në sektorët publik ose privat ku do të angazhohen.</p> <p><i>DVV Evidencë 10: Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, neni 4, pika 1;</i> <i>DVV Evidencë 12: Plani strategjik Institucional;</i> <i>DVV Evidenca: https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/rreth-departamentit-9-8-15/651/652</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi studimit Master i Shkencave në “Shkenca kompjuterike” është hartuar në përputhje me qëllimet, misionin dhe fushën e veprimtarisë së Kolegjit Universitar “Bedër”. GVJ konstaton se programi i studimit është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit në të cilën shkencat kompjuterike janë përcaktuar si një nga fushat ku KU BEDËR ofron programe studimi. Statuti i KU BEDËR përcakton qartë drejtimit prioritar akademike të tij. Në thuhet shprehimisht se “KU “Bedër”, në të gjithë veprimtarinë e tij, ka për qëllim të përgatisë specialistë të lartë me dije të nivelit bashkëkohor në fushën e teknologjisë së informacionit, shkencave kompjuterike duke zhvilluar programe studimi në profilet përkatëse në auditorë”, kjo e mbështetur dhe me rregulloret përkatëse.</p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	

	<p><i>DVV Evidencë 10: Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, nenet 1dhe 4, pika 2.a;</i> <i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore;</i> <i>DVV Evidenca 25: Rregullorja mbi Organizimin Akademik;</i> <i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve te ciklit te dyte;</i> <i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike.</i></p>		
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>KU "Bedër" ofron programe të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve dhe në fushën e shkencave kompjuterike. Në planin strategjik të IAL thuhet shprehimisht: "KU "Bedër" synon të shndërrohet në një institucion arsimor me karakter ndërkombëtar, duke ofruar mundësi studimi jo vetëm për shqiptarët, por edhe për të huajt, duke kontribuar në promovimin e Shqipërisë si një qendër rajonale e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor". Misioni i programit të studimit Master i shkencave në "Shkenca Kompjuterike" është konsolidimi i praktikave të fituara gjatë viteve të para si në përgatitjen teorike ashtu dhe atë laboratorike e profesionale.</p> <p><i>DVV Evidenca 15: Studimi i tregut te programit Master;</i> <i>DVV Evidenca: https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/master-i-shkencave-ne-shkenca-kompjuterike-7-16/616/692</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se KU "Bedër" ka në misionin e tij, objektiv kryesor përgatitjen e individëve të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë, duke ofruar mundësi studimi jo vetëm për shqiptarët në rajon, por edhe për të huajt, duke kontribuar në promovimin e Shqipërisë si një qendër rajonale e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", kjo e mbështetur dhe me rregulloret përkatëse që janë në harmoni me dokumentacionin vendas dhe ndërkombëtar, si dhe pasqyrojnë nevojat dhe trendin e tregut të punës.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike</p>	<p>GVJ konstaton, nga vlerësimi i dokumentacionit, vizitave në institucion dhe dokumentacionit shtesë të kërkuar, se KU "BEDËR" ka përvojë 12 vjeçare në fushën akademike dhe disponon kapacitetet si në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse dhe burimet e duhura. Programi i studimit ofrohet</p>

<p>për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>nga DSHK. Referuar të dhënave tabelore në RVB, Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 37 pedagogë, nga të cilët 24 janë PAE nga ku: 1 Prof.Dr., 1 Prof.As. dhe 8 kanë gradën Dr., dhe 14 asistent lektorë me Master i Shkencave, ku 1 është në process doktorature dhe 13 janë PAK, nga të cilët 3 kanë gradën Dr. dhe 10 Asistent Lektorë me Master i Shkencave. Ndërsa DSHK ka 9 PAE dhe 12 PAK.</p> <p>DVV Evidenca 15: Aneks Tabelat Përmbledhëse 1 dhe 2; DVV Evidenca 67: CV te stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësies kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Njësia kryesore, Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, ofron programe studimi në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike që prej vitit 2018. Kjo njësi kryesore ofron gjithashtu dy programe të tjera në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike: Bachelor në " Teknologji Informati dhe Komunikimi" dhe Program Profesional 2 vjeçar "Programim në Web". Programi i studimit Master i shkencave në "Shkenca Kompjuterike" ka si fushë të përgjithshme fushën e shkencave kompjuterike dhe specifike në menaxhimin e të dhënave në sasi të mëdha (Big Data) të gjeneruara nga sistemet informatike lokale dhe të shpërndara duke përdorur metodat dhe mjetet më të avancuara të Inteligjencës artificiale. Këto fusha janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësies bazë përgjegjëse për këtë program.</p> <p>DVV Evidenca 16 Organigrama e Fakultetit; DVV Evidenca 24: Organigrama e Institucionit KUB; DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". DVV Evidenca: https://www.beder.edu.al/sh/content/default/rreth-fakultetit-7-15/657/658</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësies bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>DVV Evidenca 16 Organigrama e Fakultetit; DVV Evidenca 24: Organigrama e Institucionit KUB; DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". DVV Evidenca: https://www.beder.edu.al/sh/content/default/rreth-fakultetit-7-15/657/658</p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky program ofrohet brenda profilit të KU "BEDËR".</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Programi i studimit Master i shkencave në "Shkenca Kompjuterike" është hapur për herë të parë në vitin akademik 2021-2022 dhe si i tillë nuk ka student të diplomuar. DSHK ka zhvilluar trajnime profesionale si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Code Camp Albania (Trajnim Kombëtar për zhvillimin e Softuereve) në bashkëpunim me kompanitë private(ATOM Computers); 2. Intership pranë kompanive gjatë zhvillimit të lëndëve të veçanta; 3. Trajnime nga lektorë të ftuar, nga jeta akademike dhe nga industria, në fushat respektive brenda dhe jashtë vendit.

	<p>Informacioni është publikuar dhe në faqen zyrtare të KU "BEDËR".</p> <p><i>DVV Evidenca 20: Raporti institucional 2021-2022;</i> <i>DVV Evidenca 23: Trajnimet me prof Hung;</i> <i>DVV Evidenca 27: Pershkrimi i aktiviteve te njesise ne 3 vitet e fundit;</i> <i>DVV Evidenca: https://cmp.beder.edu.al/sh/news/activities_list/</i></p>						
Konkluzione	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ evidenton se KU "BEDËR" ka eksperiencë 12 vjeçare në fushën akademike, kapacitetet si në burime burimet e duhura në mbështetje të fushës së shkencave kompjuterike, në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse. Njësia kryesore ofron programe studimi në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike që prej vitit 2018. Fushat e përgjithshme dhe specifike të programit të studimit Master i shkencave në "Shkenca Kompjuterike" janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse. Programi i studimit Master i shkencave në "Shkenca Kompjuterike" nuk ka student të diplomuar dhe këtë vit akademik diplomohen të parët, por nga njësia kryesore dhe ajo bazë janë zhvilluar trajnime profesionale, ku kanë përfituar dhe studentët e këtij program studimi.</i></p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi I.3	
<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ evidenton se IAL siguron bashkëpunimin dhe realizon ndarjen e detyrave mes njësive e personelit në rregullore, si dhe ndjekjen e zbatimit të tyre. Nga vlerësimi rezulton se DSHK menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të dytë, programi i studimit Master i shkencave në "Shkenca Kompjuterike", i cili ka një kohëzgjatje 2-vjeçare dhe në total përmban 120 kredite. GVJ konstatoi që ndarja e detyrave, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë të harmonizuara më së miri në aktet rregullatore të institucionit. Njësia bazë ka peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p><i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore;</i> <i>DVV Evidenca 25: Rregullorja mbi Organizimin Akademik;</i> <i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve te ciklit te dyte;</i> <i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike;</i></p>

	<p><i>DVV Evidenca 20: Raporti institucional 2021-2022;</i> <i>DVV Evidenca 16: RAPORTI I NJSBC 2021- 202;</i> <i>DVV Evidenca: Minutat gjate vizites ne IAL.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ evidenton se KU "Bedër" ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucionale me institucione shtetërore dhe IAL brenda dhe jashtë vendit, si dhe me kompani të biznesit, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës jo vetëm në vend. IAL duhet të zgjerojë bashkëpunimet aktuale, me universitete apo institucione kërkimore brenda dhe jashtë vendit, kjo në funksion të projekteve të kërkimit shkencor.</p> <p><i>DVV Evidenca 20: Raporti institucional 2021-2022;</i> <i>DVV Evidenca 21: Lista e bashkëpunimeve dhe MOU;</i> <i>DVV Evidenca 20: Marreveshje bashkepunimi ne kuader Erasmus me Universitetet, Rumani, Kroaci, SHBA;</i> <i>DVV Evidenca: Minutat gjate vizites ne IAL.</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në KU "Bedër", GVJ konstaton se institucioni në mbështetje të programit të studimit i ka kushtuar vëmendje të veçantë praktikave lëndore dhe profesionale të programit të studimit, si në ambientet e KU "Bedër" dhe në kuadër të marrëveshjeve të nënshkruara me institucionet perkatëse apo kompanive të biznesit (aktualisht 10 kompani). Në të njëjtën kohë ka caktuar një përfaqësues pranë zyrës së Planifikimit të Karrierës në mbështetje për përzgjedhjen e institucionit ku do të zhvillohet praktika profesionale dhe ndjekjen e zhvillimit të tyre. KU "Bedër" ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi dhe projektin ERASMUS +, për personelin akademik dhe studentë me disa Universitete ku ka përfutuar nga mobiliteti, si dhe rritja e kapaciteteve të studentëve dhe stafit akademik. Në të njëjtën kohë janë zhvilluar trajnime profesionale nga personel akademik dhe të biznesit në vend dhe jashtë. KU "Bedër" ka aplikuar në thirrjet e reja të Erasmus+ dhe projekte të reja të kërkimit shkencor, por aktualisht nuk ka projekte aktive. Nga IAL duhet të shtohet angazhimi dhe përpjekjet për zgjerimin e bashkëpunimeve aktuale, me universitete apo institucione kërkimore brenda dhe jashtë vendit, kjo në funksion të përfshirjes më të gjerë në projektet exchange dhe mobilitet të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p> <p><i>DVV Evidenca 21: Lista e bashkëpunimeve dhe MOU;</i> <i>DVV Evidenca 20: Marreveshje bashkepunimi ne kuader Erasmus me Universitetet, Rumani, Kroaci, SHBA;</i> <i>DVV Evidenca 9; Memorandum crdf projekt;</i> <i>DVV Evidenca 22: Raporti vjetor i Departamentit;</i> <i>DVV Evidenca: Minutat gjate vizites ne IAL;</i> <i>DVV Evidenca 20: Raporti institucional 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin</p>	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike, përgjegjës për programin e</p>

e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	studimit Master i shkencave në "Shkenca Kompjuterike", në raportin vjetor të tij paraqet një analizë të bashkëpunimit me aktorët e jashtëm në kuadër të procesit mësimor dhe formues. <i>DVV Evidenca 22: Raporti vjetor i Departamentit;</i> <i>DVV Evidenca 20: Raporti institucional 2021-2022.</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës GVJ konstaton se KU "Bedër" siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. KU "BEDËR" ka aplikuar në thirrjet e reja të Erasmus+ dhe projekte të reja të kërkimit shkencor, por aktualisht nuk ka projekte aktive, ku përfitues është programi i studimit. Nga IAL duhet të shtohet angazhimi dhe përpjekjet për zgjerimin e bashëpunimeve aktuale, me universitete apo institucione kërkimore brenda dhe jashtë vendit, kjo në funksion të projekteve të kërkimit shkencor dhe në funksion të përfshirjes më të gjerë në projektet exchange dhe mobilitet të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet kryesisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri I. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ konstaton se struktura e programit të studimit Master i shkencave në "Shkenca Kompjuterike" është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi, dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 2 vite dhe në total 120 kredite dhe përmban të shprehura shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj, të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore.

	<p>Nga shqyrtimi i programit mësimor, rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018, dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh. Përqindja sipas secilit tip të komponentit mësimor është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lëndët bazë 10%; • lëndët karakterizuese 50%; • lëndët ndërdisiplinore 15%; • lëndët plotësuese 10%; • detyrimet përmblyëse 15 %. <p><i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve te ciklit te dyte;</i> <i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore;</i> <i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike”;</i> <i>DVV Evidenca: Aneks Tabelat përmbledhëse – Tabela 9;</i> <i>DVV Evidenca: https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/master-i-shkencave-ne-shkenca-kompjuterike-7-16/616/692.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Master i shkencave në “Shkenca Kompjuterike” synon t’i përgatisë dhe formojë studentët me njohuri të thelluara akademike, kompetenca dhe njohuri të aplikuara në fushën e shkencave kompjuterike, analizimit të të dhënave në mënyrë inteligjente dhe elementëve të sistemeve të informacionit, në mënyrë që të arrijnë përmbushje profesionale në një treg kombëtar, rajonal dhe botëror, si dhe të përgatisë specialistë me kualifikim të lartë me njohuri nga fusha e programimit në objekte dhe programimit në Web, menaxhimit të bazave të të dhënave, programimit inteligjent, sigurisë kibernetike dhe përpunimit të informacionit në sasi të mëdha. Ndër synimet kryesore të programit është edhe përgatitja e studentëve me aftësi teorike dhe praktike, të gatshëm për t’u përballur me kushtet e një tregu të hapur global në fushën e shkencave kompjuterike, përmes kombinimit të teorisë me praktikën. GVJ konstaton se ky objektivi përmbushet mjaft mirë dhe kjo rezulton e shprehur qartë në rregulloren e programit dhe në syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike”;</i> <i>DVV Evidenca 26: Syllabuset e Lendeve;</i> <i>DVV Evidenca: https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/master-i-shkencave-ne-shkenca-kompjuterike-7-16/616/692.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës</p>	<p>Programi i studimit Master i shkencave në “Shkenca Kompjuterike” ka të përcaktuar ngarkesën 12 kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe 18 kredite të detyrimit përmblyës të punimit të diplomës.</p>

profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	<i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike</i> ; <i>DVV Evidenca: Aneks Tabelat përmbledhëse – Tabela 9.</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk aplikohet në këtë program studimi.
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet në këtë program studimi.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	GVJ konstaton se Programi i studimit Master i shkencave në "Shkenca Kompjuterike" ka të përcaktuar formën e organizimit, pranimin e studentëve dhe financimin në aktet rregullatore, në zbatim dhe në përputhje me aktet ligjore dhe rregullatore. <i>DVV Evidenca 10: Statusi i KUB;</i> <i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike</i> ".
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" ka një plan mësimor të ngjashëm programet e studimit në fushë mbi masën 70 %, pasi dhe hapja e këtij programi është mbështetur në eksperiencat më të sukseshme dhe ndërkombëtare të fushës. <i>DVV Evidenca: Aneks Tabelat përmbledhëse – Tabela 9;</i> <i>DVV Evidenca 26: Syllabuset e Lendeve;</i> <i>DVV Evidenca: https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/master-i</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe	GVJ konstaton KU "Bedër" është në proces kodifikimi të programit të studimit, në bazë të VKM nr. 310, datë 11.5.2022 "Për specifikimet dhe

klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	përbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Kodi i propozuar për programin e studimit është 72MS0619S.								
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet në këtë program studimi.								
Konkluzione	<i>Ky program studimi është organizuar nga IAL në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore dhe është në proces kodifikimi i programit të studimit.</i>								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>			Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
		Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri I. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Institucioni ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.57, datë 16.12.2021 që e akrediton institucionin për 5 vite akademike. Njësitë kryesore të Kolegjit Universitar "Bedër" janë riorganizuar me Urdhër nr. 200, datë 3.7.2020 "Për riorganizimin e njësive kryesore të Kolegjit Universitar "Bedër".</p> <p>Rezulton se Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamentin e Shkencave Kompjuterike; • Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit; • Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshem dhe Inovacion; <p>Njësia kryesore "Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit" është riorganizuar me urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 200, datë 3.7.2020 "Për riorganizimin e njësive kryesore të Kolegjit Universitar "Bedër". Ky Fakultet ka në përbërje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamentin e Shkencave Kompjuterike; • Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit;

• Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshem dhe Inovacion.

Përvec programit të studimit Master i shkencave në "Shkenca Kompjuterike", DSHK ofron studime dhe në 3 programe, një program me karakter profesional dhe 2 të ciklit të parë bachelor. Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive kryesore dhe asaj bazë që janë përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me përcaktimet ligjore. Dekani i fakultetit mban titullin akademik "Prof. As" ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, "Doktor i Shkencave".

Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit në vitin akademik 2022-2023, ka në përbërje të tij 37 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 24 janë personel akademik efektiv (PAE), dhe 13 personel akademik me kontratë (PAK).

Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2022-2023:

Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit:

- 7 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada;
- 1 PAK;

Departamenti i Shkencave Kompjuterike:

- 9 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada;
- 12 PAK, ndër të cilët 3 me tituj / grada;

Qendra për Zhvillim të Qëndrueshem dhe Inovacion:

- 8 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada;
- 0 PAK;

Ndërsa stafi akademik i Departamentit të Shkencave Kompjuterike dhe Njësia kryesore "Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit", që janë përgjegjës për programin e studimit, në vitin akademik 2022-2023 është: 6 personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 4 me grada shkencore dhe 7 staf akademik me kontratë (PAK), nga të cilët 3 me grada shkencore. Raporti PAE/PAK për këtë program studimi është si:

Viti akademik	Raporti PAE/PAK
2021-2022	7/5
2022-2023	6/7

Vlen të theksojmë që personeli i fuar akademik janë ekspertë me eksperiencë dhe të certifikuar në fushat dhe modulet që mbulojnë dhe nga agjenci shtetërore dhe kompani lider në fushat respektive. Nga verifikimi i personelit akademik i përfshirë në mësimdhënie, konstatohet një qëndrueshmëri në stafin akademik.

Për sa më sipër GVJ konstaton se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për numrin dhe kualifikimin grada/tituj të PAE.

	<p>Personeli akademik (PAE dhe PAK) i njësive kryesore dhe njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të kenë minimumi gradën shkencore "Doktor" sipas kriterit të parashikuar në Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë", neni 59, pika 6 ku citohet: "Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës". Ky kriter nuk përmbushet pasi nga 13 anëtarë të personelit akademik (PAE dhe PAK) për vitin akademik 2022-2023, 6 janë me gradën Master i Shkencave.</p> <p>Nga verifikimi i të dhënave statistikore, u konstatua se ngarkesa mësimore është mbuluar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për vitin 2021-2022, 60 % nga PAE dhe 40% PAK; • për vitin 2022-2023, mbi 73% nga PAE dhe 27 % PAK. <p>Kriteri që stafi akademik PAE të mbulojë të paktën 70% të ngarkesës përmbushet vetëm për vitin akademik 2022-2023.</p> <p><i>DVV Evidenca 6: Urdher për riorganizimin e njësive kryesore të KUB;</i> <i>DVV Evidenca 10: Statusi i KUB;</i> <i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkencë Kompjuterike";</i> <i>DVV Evidenca: Aneks Tabelat përmbledhëse – Tabela 1, 2 dhe 6.2;</i> <i>DVV Evidenca shtesë: 22. Tabela e ngarkesës;</i> <i>DVV Evidenca 26: Syllabuset e Lendeve;</i> <i>DVV Evidenca: https://beder.edu.al/sh/content/default/rreth-fakultetit-13-7/657/658;</i> <i>DVV Evidenca: https://beder.edu.al/sh/content/default/departamenti-i-shkencave-kompjuterike-10-6/657/59.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe vizita në IAL, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, në plotësim të detyrimeve të përcaktuara ligjore ka të angazhuar për programin e studimit, 2 personel ndihmës akademik për realizimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore.</p> <p><i>DVV Evidenca: Aneks Tabelat përmbledhëse – Tabela 1, 2;</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe vizita në IAL, GVJ konstaton se DSHK si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i shkencave në "Shkencë Kompjuterike" ka caktuar këshilltarin akademik të programit të studimit, që është dhe koordinatori i programit të studimit - me vendim të Këshillit të DSHK. Ai kryen detyrat e ngarkuara dhe merr masat e nevojshme në funksion të mbarëvajtjes së programit të studimit.</p> <p><i>DVV Evidenca. 25: Rregullorja mbi organizimin akademik", neni 18;</i></p>

praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	DVV Evidenca 19: Vendimi i Keshillit të Departamentit për keshilltarin akademik.		
Konkluzione	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe vizita në IAL, GVJ evidenton se kriteret e këtij standarti për programin e studimit përmbushen kryesisht, pasi kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për njësinë kryesore dhe bazë përgjegjëse përmbushen, por nuk përmbushet shkalla e kualifikimit(titujt) e personelit akademik që mbulon programin e studimit dhe kriteri që stafi akademik PAE të mbulojë të paktën 70% të ngarkesës përmbushet vetëm për vitin akademik 2022-2023.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Shkencave Kompjuterike, si njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e Programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca kompjuterike", disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky informacion publikohet dhe në faqen kryesore të KU "Bedër" duke përfshirë plan programin e studimit. Departamenti i Shkencave Kompjuterike, disponon informacionet dhe ka vënë në dispozicion dokumentacionin për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: rregulloren, programin mësimor, syllabuset e lëndëve, stafin akademik të programit etj.</p> <p><i>DVV Evidenca 6: Urdher për riorganizimin e njësive kryesore të KUB;</i> <i>DVV Evidenca 10: Statusi i KUB;</i> <i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike";</i> <i>DVV Evidenca: Aneks Tabelat përmbledhëse</i> <i>DVV Evidenca shtesë: 22. Tabela e ngarkesës;</i> <i>DVV Evidenca 26: Syllabuset e Lendëve;</i> <i>DVV Evidenca: https://beder.edu.al/sh/content/default/rreth-fakultetit-13-7/657/658;</i> <i>DVV Evidenca: https://beder.edu.al/sh/content/default/departamenti-i-shkencave-kompjuterike-10-6/657/59.</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore	GVJ konstaton se veprimtaritë formuese janë shpërndarë në përputhje me VKM 41, dt.24.01.2018. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën mëposhtë:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

19

të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Kategoria	Pershkrimi	% sipas VKM 41	Kredite/ ECTS	%
	A	Lëndë bazë	5%-10%	12	10%
	B	Lëndë karakterizuese	50% - 60%	60	50%
	C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12%-20%	18	15%
	D	Lëndë plotësuese (praktika profesionale)	10%	12	10%
	E	Detyrime përmbyllëse (punimi u diplomës)	10%- 15%	18	15%

Nga shqyrtimi i rregullores së programit, planit mësimor dhe syllabuseve, GVJ konstaton se programi përmban 17 lëndë, nga të cilat 2 me zgjedhje + praktikën profesionale + punimin e diplomës. Në syllabuset e lëndëve paraqitet qartë ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar, laborator, detyrë apo project kursi).

Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për:

- ngarkesën mësimore, sipas veprimtarive mësimore: leksion, seminar, laborator, detyrë kursi etj;
- orët në auditor/ jashtë auditorit, që studenti kryen për secilën lëndë dhe për çdo element të saj, gjatë një semestri;
- Grupin e lëndëve që studenti kryen çdo semester dhe çdo vit akademik;
- Numrin total të krediteve që fiton studenti si dhe numrin e krediteve për secilën lëndë.

DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike";
DVV Evidenca: Aneks Tabelat përmbledhëse, Tabelat 9,10,11,12.1 dhe 12.2
DVV Evidenca shtesë: 22. Tabela e ngarkesës;
DVV Evidenca 26: Syllabuset e Lendëve;

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se 'Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" dhe rregullorja e transferimit të studimeve, përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me pranimin, regjistrimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. GVJ citon nga rregullorja e programit: "Kriteret e pranimit të studentëve propozohen nga DSHK dhe miratohen nga Senati Akademik brenda periudhës së përcaktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe dërgohen në institucionet e MAS, QSHA dhe

	<p>RASH: Kriteret publikohen dhe janë të aksesueshme në portalin U-Albania dhe në faqen zyrtare të KU "BEDËR".</p> <p><i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike</i>;</p> <p><i>DVV Evidenca 27: Rregullorja e Transferimit të Studimeve.</i></p>		
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në rregulloren e programit të studimit, si dhe në syllabuset e lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm mbi detyrimin e frekuentimit / ndjekjes së programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj. Syllabuset e lëndëve janë hartuar sipas formatit të miratuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, dt. 24. 01. 2018 dhe informojnë në lidhje me detyrimin për frekuentimin/ ndjekjen e programit nga studenti, mënyrën e vlerësimit të dijeve, literaturën, sasia e orëve mësimore për çdo tematikë të lëndës, pedagogun e lëndës etj. GVJ evidenton se në syllabuset e lëndëve mungon titullari i lëndës në shumicën prej tyre dhe nuk janë të përcaktuara temat e detyrave/projekteve të kursit dhe të punëve laboratorike.</p> <p><i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike</i>;</p> <p><i>DVV Evidenca 26: Syllabuset e Lendeve.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në IAL janë të mirëpërcaktuara procedurat që ndiqen për përmirësimet dhe ndryshimet në përmbajtjen e programit të studimit, në fillim të çdo viti akademik. Aktualisht ka përmirësime të disa syllabuseve, por nuk ka ndryshime në planin mësimor të programit të studimit.</p> <p><i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike</i>;</p> <p><i>DVV Evidenca: Aneks Tabelat përmbledhëse, Tabelat 9,10,11 dhe 14;</i></p> <p><i>DVV Evidenca 26: Syllabuset e Lendeve;</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca kompjuterike" disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky informacion publikohet dhe në faqen kryesore të KU "BEDËR" duke përfshirë planin e studimit, në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. GVJ rekomandon të shtohet dhe plotësohet në syllabuset e lëndëve të programit të studimit, në rastet e munguara titullari i lëndës, si dhe të përcaktohen temat e detyrave/projekteve të kursit dhe të punëve laboratorike.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi II.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

21

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.									
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se emërtimi i programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca kompjuterike" është në përputhje me fushën akademike të tij. Shpërndarja e lëndëve dhe përmbajtja e veprimtarive mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike. Praktikant lëndore dhe aktivitetet për aftësimin e tyre profesional në institucione dhe kompani të ndryshme u kanë mundësuar studentëve aftësimin dhe në disa raste punësimin e studentëve.</p> <p><i>DVV Evidenca: https://cmp.beder.edu.al/sh/news/activities_list/.</i></p>								
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se mundësohet arritja e objektivave formues të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca kompjuterike" dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Disa lëndë të rëndësishme për realizimin e objektivave dhe rezultateve të programit të studimit, në fushën e shkencave kompjuterike janë: "Data Mining I dhe II", "Sisteme operimi të avancuara", "Programim OO i avancuar", "Sistemet e menaxhimit të bazave të të dhënave", "Sistemet e shpërndara dhe Cloud Computing", "Programim i Avancuar ne Python" dhe "Siguria në Rrjetat kompjuterike". Shpërndarja e ngarkesës mësimore në të katërt semestrat e realizimit të programit është e balancuar me 30 kredite për çdo semester.</p> <p>Ngarkesa mësimore javore është:</p> <table border="0"> <tr> <td>1. Semestri I</td> <td>22 orë;</td> </tr> <tr> <td>2. Semestri II</td> <td>21 orë;</td> </tr> <tr> <td>3. Semestri III</td> <td>22 orë;</td> </tr> <tr> <td>4. Semestri IV</td> <td>5 orë.</td> </tr> </table> <p>Struktura, lëndët dhe raporti teori-praktikë janë në përputhje me profilin e shkencave kompjuterike. Raporti teori/praktikë në auditor është 64% me 36 %. Ky program studimi është i përafëruar me programe të ngjashme ndërkombëtare, pasi dhe hapja e këtij programi është mbështetur në eksperiencat më të sukseshme dhe ndërkombëtare të fushës duke mundësuar arritjen e objektivave formues, kërkimin shkencor dhe formimin e specialistëve të aftë në fushën e shkencave kompjuterike.</p> <p>Studentë të këtij programi studimi kanë marrë pjesë në konferenca shkencore me mentorimin e stafit akademik që mbulon programin e studimit.</p> <p><i>DVV Evidenca: Aneks Tabelat përmbledhëse, Tabelat 9, 10 dhe 13 DVV Evidenca shtesë 30: Shembull Orari mesimor (tt.beder.edu.al);</i></p>	1. Semestri I	22 orë;	2. Semestri II	21 orë;	3. Semestri III	22 orë;	4. Semestri IV	5 orë.
1. Semestri I	22 orë;								
2. Semestri II	21 orë;								
3. Semestri III	22 orë;								
4. Semestri IV	5 orë.								
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>									

	<p><i>DVV Evidenca shtesë 28: Lista e konferencave dhe e botimeve te stafit dhe studenteve viti akademik 2021-2022;</i> <i>DVV Evidenca: https://tt.beder.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në këtë program studimi 675 orë në auditor janë leksione, 225 orë në auditor janë seminare, 75 orë në auditor janë laboratore dhe 30 orë janë praktikë. Numri i orëve për diplomën është 45 dhe numri i orëve për studim individuale është 1950. Gjatë intervistave me personelin akademik dhe me studentët si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet se raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve dhe mobilitet gjatë studimit, si dhe aftësimin e tyre për tregun e punës në fushën e shkencave kompjuterike.</p> <p><i>DVV Evidenca: Aneks Tabelat përmbledhëse, Tabelat 9,10,11,13 dhe 14;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 22: Tabela e ngarkesës;</i> <i>DVV Evidenca 26: Syllabuset e Lendeve.</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në IAL janë të mirëpërcaktuara procedurat që ndiqen për përmirësimet dhe ndryshimet në planin mësimor të programit të studimit dhe syllabuset e programit të studimit. Në fillim të çdo viti akademik, syllabuset ngarkohen në sistemin informatik Beder Information System (BIS) bashkë me përditësimet e nevojshme duke përcaktuar edhe literaturën e detyruar dhe literaturën ndihmëse. Nga vlerësimi i literaturës së lëndëve, në syllabuse, konstatohet që për një pjesë të tyre, nuk është e 5 viteve të fundit sipas kriterit përkatës.</p> <p><i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike”;</i> <i>DVV Evidenca: Aneks Tabelat përmbledhëse, Tabelat 9,10,11dhe 14;</i> <i>DVV Evidenca 26: Syllabuset e Lendeve.</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimn e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Në përputhje dhe me rregulloret përkatëse, qëllimi kryesor i programeve të studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave" është të pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike dhe aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Ky program studimi është hapur mbështetur në eksperiencën të sukseshme dhe ndërkombëtare të fushës duke mundësuar arritjen e objektivave formues dhe përfitimn e njohurive, formimin e specialistëve të aftë në fushën e shkencave kompjuterike. Studentët e programit të studimit kanë marrë pjesë në konferenca në fushën e shkencave kompjuterike.</p> <p><i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve te ciklit te dyte, neni 3;</i> <i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike”;</i> <i>DVV Evidenca: Aneks Tabelat përmbledhëse, Tabela 22;</i> <i>DVV Evidenca 26: Syllabuset e Lendeve.</i></p>

<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit jep mundësi të mëtejshme studimi dhe punësimi të studentëve në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Këtë e tregojnë shkalla e lartë e punësimit të studentëve të programit të studimit, në institucione dhe kompani të njohura të fushës.</p> <p>DVV Evidenca shitesë 3: Kompanite ku jane punesuar studentet e masterit te Shkenca Kompjuterike.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, përputhje me nivelin 7 të KSHK-së, rezultateve të të nxënies, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës në fushën e shkencave kompjuterike. GVJ rekomandon që në syllabuset e lëndëve të azhurnohet literatura, pasi duhet të jetë e 5 viteve të fundit.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në IAL janë hartuar politikat e KU "Bedër" për përmirësimin e programeve të studimit. Vlerësimi i programeve të studimit dhe i mësimdhënies realizohet me mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore duke marrë parasysh mendimet dhe reagimet e personelit të KU "Bedër", studentëve të programit të studimit, të diplomuarve si dhe ekspertëve të jashtëm, që bashkëpunojnë me IAL. Vlerësimi ka për qëllim identifikimin e pikave të forta dhe atyre që kanë nevojë për përmirësim dhe kjo vlen për të gjitha programet e studimit që ofron IAL.</p> <p>Gjatë takimeve në IAL, GVJ konstatoi se departamenti dhe këshilltari i karrierës, në bashkëpunim me zyrën e planifikimit të karrierës organizojnë takime dhe aktivitete të stafit akademik dhe studentëve me të ftuar nga bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga institucione partnere dhe tregu i punës. Keto takime kanë në fokus përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit, në përputhje me komentet dhe sugjerimet e marra nga punëdhënësit, që përfaqësojnë një kontribut të vlefshëm në procesin e rishikimit vjetor të programit të studimit me zhvillimet teknologjike, kërkesat dhe pritshmëritë e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Gjithashtu u konstatua një bashkëpunim shumë i ngushtë me bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i punës të cilët ftoheshin dhe të japin mësim. DSHK nuk ka depozituar një studim të mirëfilltë të</p>

	<p>tregut të punës për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca kompjuterike".</p> <p><i>DVV Evidenca 58: Politikat e KU beder per permiresimin e programeve te studimi;</i></p> <p><i>DVV Evidenca 18: Vendimi i Keshillit te Departamentit per perfaqesuesin ne zyren e karrieres;</i></p> <p><i>DVV Evidenca 21: Lista e bashkëpunimit dhe MOU;</i></p> <p><i>DVV Evidenca: https://cmp.beder.edu.al/sh/neës/activities_list/.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në kuadër të përmirësimit të programit, IAL nxit dhe përfshin në diskutime dhe studentët nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Anketimit për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nga studentët e regjistruar që realizohet në semestrin e fundit me studentët në prag diplomimi. Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit nga studentët e diplomuar realizohet pas diplomimit. 2. Përfshirjen në strukturat e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë 3. Pjesëmarrjen në këshillin e DSHK. <p>Studentët e parë të këtij program studimi diplomohen në vitina akademik 2022-2023.</p> <p><i>DVV Evidenca 38: Anketa me studentë për programin e studimit;</i></p> <p><i>DVV Evidenca: Aneks Tabelat përmbledhëse, Tabela 24;</i></p> <p><i>DVV Evidenca 10: Prezantimi i NJSBC për studentët.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>DSHK në zbatim të marrëveshjeve dhe bashkëpunimit me ekspertët në fushën e shkencave kompjuterike, kompanitë e sukseshme që operojnë në vend, me institucionet partnere ndërkombëtare dhe Agjencitë shtetërore në vend, bashkëpunon duke ftuar si staf PAK, si lektor i ftuar, aktivitete specifike teknologjike të përbashkëta apo në bashkëpunimet në kuadër të praktikave dhe intershipeve lëndore apo dhe projekteve të përbashkëta. Të gjitha këto reflektohen në nevojat për përmirësim dhe azhurnim të kurrikulave të programit të studimit.</p> <p><i>DVV Evidenca 58: Politikat e KU beder per permiresimin e programeve te studimi;</i></p> <p><i>DVV Evidenca 18: Vendimi i Keshillit te Departamentit per perfaqesuesin ne zyren e karrieres;</i></p> <p><i>DVV Evidenca 21: Lista e bashkëpunimit dhe MOU;</i></p> <p><i>DVV Evidenca: https://cmp.beder.edu.al/sh/neës/activities_list/.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ evidenton se në IAL, njësitë përgjegjëse angazhohen në përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, bashkëpunëtorëve në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat dhe kërkesat në fushë. GVJ rekomandon që DSHK duhet të kryejë një studim të mirëfilltë të tregut të punës për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca kompjuterike", në</i></p>

	<i>mënyrë që të reflektojë përmirësimet e nevojshme që lidhen me zhvillimin dhe prirjet kombëtare dhe globale të zhvillimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Statuti i KU "BEDËR" përcakton prioritetet dhe objektivat kryesorë të programeve të studimit që ofron. Prioriteti kryesor është kërkimi shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. Këto prioritete dhe objektiva janë të përcaktuara më qartë e me detaje në rregulloret e veçanta:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë; 2. Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike. <p><i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve te ciklit te dyte;</i> <i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike".</i></p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	<p>DSHK synon rritjen e cilësisë së programeve të studimit dhe nxit, mbështet, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore të departamentit dhe programit të studimit. Për maksimizim të arritjeve, duhet që stafi të mbulojë dhe përfshihet në fushën e ekspertizës, pra duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit të tyre. Ky kujdes fillon që në momentin e rekrutimit të stafit të ri.</p> <p><i>DVV Evidencë: Takimi me stafin akademik</i></p>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	<p>Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, trajnime, projekte dhe aktivitete kërkimore me mbështetjen dhe mentorimin e stafit akademik dhe IAL, në intershipet lëndore, pjesëmarrjet në konferenca dhe aktivitete të promovimit të arritjeve në fushën e shkencave kompjuterike si Code Camp Albania dhe trajnime të ndryshme të ofruara nga kompanitë e fushës, që bashkëpunojnë me DSHK ose lektorët e ftuar nga institucione homologe brneda dhe jashtë vendit. Nga ana e tyre studentët synojnë të kenë sa më shumë eksperiencë pune në portofolet e tyre, si rrjedhim interesi është i përbashkët në pjesëmarrjen e tyre në projekte të kërkimit shkencor.</p> <p><i>DVV Evidenca 68: Rregullorja mbi projektet kërkimore shkencore;</i></p>

	<p><i>DVV Evidenca shtesë 28: Lista e konferencave dhe e botimeve te stafit dhe studenteve viti akademik 2021-2022;</i> <i>DVV Evidenca 21: Lista e bashkëpunimit dhe MOU;</i> <i>DVV Evidencë: Takimi me studentët.</i></p>		
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Veçoria e programit të studimit Master i shkencave në "Shkenca Kompjuterike" ka të bëjë me kërkesën e vazhdueshme për nevojën e përdorimit të teknologjive bashkëkohore për realizimin e aktiviteteve mësimore, studimore, kërkimore e shkencore. IAL ka përcaktuar në rregulloren e projekteve kërkimore shkencore, mbështetjen ndaj stafit akademik për botimet dhe pjesëmarrjet në aktivitete shkencore. Në këtë rregullore përcaktohet "Veprimtaria kërkimore-shkencore financohet nga buxheti i universitetit dhe nga partnere të jashtëm, hashkëpunetore apo nga kontribute vullnetare në përputhje me misionin dhe politikat e universitetit. Buxheti për kërkimin shkencor mbulon shpenzimet për konferencat, revistat shkencore, publikimet, projektet dhe aktivitete të tjera kërkimore.". Njësia bazë DSHK mbështetet financiarisht nga IAL për realizimin e aktiviteteve të parashikuara të saj.</p> <p><i>DVV Evidenca 68: Rregullorja mbi projektet kërkimore shkencore;</i> <i>DVV Evidenca 65: Projektbuxheti.</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në statutin e IAL, është përcaktuar si prioritet kryesor kërkimi shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. Këto prioritete dhe objektiva janë të përcaktuara më qartë në rregulloret e veçanta të programit të studimit. DSHK nxit, mbështet, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimit dhe veprimtaritë kërkimore të departamentit dhe programit të studimit. Në të njëjtën kohë nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, trajnime projekte dhe aktivitete kërkimore me mbështetjen dhe mentorimin e stafit akademik dhe IAL, në intershipet lëndore, pjesëmarrjet në konferenca dhe aktivitete të promovimit të arritjeve në fushën e shkencave kompjuterike. Njësia bazë DSHK mbështetet financiarisht nga IAL për realizimin e aktiviteteve të saj. IAL ka përcaktuar në rregulloret e saj mbështetjen ndaj stafit akademik dhe për botimet dhe pjesëmarrjet në aktivitete shkencore ndërkombëtare.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p>Standardi IL7 Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të</p>	<p>IAL dhe DSHK mbështet kërkimin shkencor dhe synon lidhjen e ngushtë midis programit të studimit dhe produktit për tregun e punës. Prandaj KU "Bedër" mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr.219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

27

<p>reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>përmes mbështetjes financiare por edhe në bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore në KU "Bedër" dhe universitetet partnere, në aktivitete të ndryshme të kërkimit shkencor në mbështetje dhe të programit të studimit. projektet ku është përfshirë, si dhe me kompani që kanë objektiva të ngjashme me programin e studimit në kërkimin shkencor. Nga IAL duhet të shtohen angazhimi për zgjerimin e bashkëpunimeve me universitete, institucione kërkimore apo me kompanitë në fushë, brenda dhe jashtë vendit, kjo në funksion të realizimit të projekteve të kërkimit shkencor.</p> <p><i>DVV Evidencë shtesë 23: Trajnimet me prof Hung</i> <i>DVV Evidencë: https://cmp.beder.edu.al/sh/neës/activities/albania-code-camp-2022-6/1837</i> <i>DVV</i> <i>Evidencë: https://cmp.beder.edu.al/sh/neës/announcements/leksion-i-hapur-per-studentet-e-masterit-me-teme-perdorimi-i-teknologjise-ne-kryerjen-e-kerkimit-/1868</i> <i>DVV</i> <i>Evidencë: https://cmp.beder.edu.al/sh/neës/announcements/leksion-i-hapur-me-teme-decentralized-ledger-technology-and-blockchain-nga-z-klevis-shkembj/1885</i> <i>Evidenca Shtesë 2: Lista e marreveshjeve per vitin 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>DSHK si njësi përgjegjëse për cilësinë e programit të studimit, angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik me ekspertizën e duhur dhe studentët më të mirë për realizimin e këtyre aktiviteteve kërkimore e shkencore. Vlen të theksojmë se 2 studentë të programit të studimit janë punësuar dhe si asistentë lektorë. Në mënyrë specifike DSHK ka angazhuar stafin akademik dhe studentët në lidhje me realizimin e konferencës shkencore dhe revistës periodike të KU "Bedër", pjesëmarrjen në konferenca dhe organizon aktivitete të ndryshme në funksion të kërkimit shkencor dhe realizimit të objektivave të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p><i>DVV Evidencë: https://icibt.beder.edu.al/</i> <i>DVV Evidencë: https://ejtb.beder.edu.al/</i> <i>DVV Evidencë shtesë 17: Publikime te stafit</i> <i>DVV Evidencë shtesë 23: Trajnimet me prof Hung</i> <i>DVV Evidencë: https://cmp.beder.edu.al/sh/neës/activities/albania-code-camp-2022-6/1837</i> <i>DVV</i> <i>Evidencë:</i> <i>https://cmp.beder.edu.al/sh/neës/announcements/leksion-i-hapur-per-studentet-e-masterit-me-teme-perdorimi-i-teknologjise-ne-kryerjen-e-kerkimit-/1868</i> <i>DVV</i> <i>Evidencë:</i> <i>https://cmp.beder.edu.al/sh/neës/announcements/leksion-i-hapur-me-</i></p>

	<p><i>teme-decentralized-ledger-technology-and-blockchain-nga-z-klevis-shkemi/1885</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Objektivat e mësimdhënies në këtë program fokusohen në përgatitjen e individëve me aftësi profesionale dhe që janë të aftë të adoptohen me sukses në tregun e punës. Aktivitetet e ndryshme të organizuara nga IAL dhe DSHK në bashkëpunim me universitetet dhe kompanitë apo agjencitë partnere, ku përfitojnë dhe studentët e këtij program studimi, praktikat lëndore dhe praktika profesionale, lehtësojnë arritjen e objektivave të mësimdhënies, si dhe aftësimin profesional konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës, të studentëve në përfundim të programit të studimit. Pjesa më e madhe e studentëve janë të punësuar në fushën e programit të studimit.</p> <p><i>DVV Evidencë shtesë 3: Kompanite ku jane punesuar studentet e masterit te Shkenca Kompjuterike</i> <i>DVV Evidencë shtesë 27: Pershkrimi i aktiviteteve te njesise ne 3 vitet e fundit</i> <i>DVV Evidencë shtesë 23: Trajnimet me prof Hung</i> <i>DVV Evidencë: https://cmp.beder.edu.al/sh/neës/activities/albania-code-camp-2022-6/1837</i> <i>DVV Evidencë: https://cmp.beder.edu.al/sh/neës/announcements/leksion-i-hapur-me-teme-decentralized-ledger-technology-and-blockchain-nga-z-klevis-shkemi/1885</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fashës.</p>	<p>Fusha e programit të studimit nuk është një profesion i rregulluar me ligj dhe si rrjedhojë me detyrimin ligjor për tu licensuar. DSHK në zbatim të marrëveshjeve dhe bashkëpunimit me ekspërtët në fushën e shkencave kompjuterike, kompanitë e sukseshme që operojnë në vend, më institucionet partnere ndërkombëtare dhe agjencitë shtetërore në vend, bashkëpunon duke ftuar si staf PAK, si lektor i ftuar, duke organizuar aktivitete specifike të përbashkëta apo në bashkëpunimet në kuadër të praktikave dhe intershipeve lëndore apo dhe projekteve të përbashkëta. Të gjitha këto reflektohen në nevoja për përmirësim dhe azhurnim të kurrikulave të programit të studimit.</p> <p><i>DVV Evidenca 58: Politikat e KU beder per permiresimin e programeve te studimi;</i> <i>DVV Evidenca 18: Vendimi i Keshillit te Departamentit per perfaqesuesin ne zyren e karrieres;</i> <i>DVV Evidenca 21: Lista e bashkëpunimit dhe MOU;</i> <i>DVV Evidenca: https://cmp.beder.edu.al/sh/neës/activities_list/.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të</p>	<p>Fusha e programit të studimit nuk është një profesion i rregulluar me ligj.</p>

Bashkimt Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).											
Konkluzione	<i>IAL dhe DSHK mbështet kërkimin shkencor dhe synon lidhjen e ngushtë midis programit të studimit dhe produktit për tregun e punës përmes mbështetjes financiare por edhe në bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore në KU "BEDËR" dhe universitetet partnere. Nga IAL duhet të shtohen angazhimi zgjerimin e bashkëpunimeve me universitete, institucione kërkimore apo me kompanitë në fushë, brenda dhe jashtë vendit, kjo në funksion të realizimit të projekteve të kërkimit shkencor. Objektivat e mësimdhënies në këtë program fokusohen në përgatitjen e individëve me aftësi profesionale dhe me nivel të lartë të të menduarit kritik, të edukojë profesionistë që janë të aftë të adoptohen me sukses në tregun e punës ndërkombëtar të punës. Fusha e programit të studimit nuk është një profesion i rregulluar me ligj.</i>										
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>				Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					X
			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht							
				X							
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>				Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					X
			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht							
				X							

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucional i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në KU "Bedër", GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca kompjuterike" zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminarëve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale të miratuara nga IAL bazuar në rregulloret specifike. Në mënyrë specifike personeli akademik është trajnuar dhe udhëzuar mbi metodat e reja të mësimdhënies innovative.</p> <p><i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore, nenet 55 dhe 56;</i> <i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë;</i></p>

<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p><i>DVV Evidenca 69: Udhezim mbi mesimdhënien innovative.</i></p> <p>Gjatë vizitës në KU "Bedër", GVJ konstatoi se personeli akademik i programit të studimit merr në konsideratë nevojat e studentëve dhe bashkëpunon me ta për të ofruar një eksperiencë mësimdhënie-mësimnxënie sa më të mirë.</p> <p>Personeli akademik në KU "BEDËR" synon të respektojë dhe t'i përgjigjet nevojave dhe kërkesave të ndryshme të studentëve, duke ofruar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit; 2) në përputhje me aktivitetet formuese; 3) praktika lëndore në kompani dhe institucione; 4) në përgjigje të nevojave të studentëve dhe atyre me aftësi ndryshe; 5) është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. <p>Duke pasur parasysh natyrën unike të çdo lënde, kriteret e vlerësimit ndryshojnë nga një lëndë në tjetrën. Është një kombinim i mësimdhënies tradicionale me metodat inovative si: miniprojekt në laborator, provimet e aplikimit, analiza kritike e punimeve kërkimore etj.</p> <p>Universiteti ofron një sërë bursash:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Bursat e ekselencës, të përshkallëzuar në varësi të rezultateve; 2. Bursat sociale; 3. Bursat e trevave. <p>Vlen të theksojmë se të gjithë studentët e pranishëm në takim përfitonin nga bursat e mësipërme. Dy studentë të programit të studimit janë punësuar dhe si asistentë lektorë.</p> <p><i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve te ciklit te dyte;</i> <i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike;</i> <i>DVV Evidenca 69: Udhezim mbi mesimdhënien innovative;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 26: Syllabuset e Lendeve;</i> <i>DVV Evidenca shtesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 7: Lista e studenteve Master qe kane perfutuar zbritje te tarifes se studimit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se KU "BEDËR" angazhohet në mbështetjen e personelit akademik për përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike. Ai inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnuese, leksione të hapura dhe workshope me profesorë të ftuar nga universitete të dalluara. GVJ pas vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i programit i mundësojnë personelit akademik përdorimin e metodave të shumëllojshme të mësimdhënies.</p> <p><i>DVV Evidenca 30: Lista e trajnimeve të stafit, viti akademik 2020-2022;</i></p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mesimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mesimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>DVV Evidenca 69: Udhezim mbi mesimdhënie innovative.</p> <p>Procesi i kompetencës së mesimdhënies mbështetet në këto etapa:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fillon nga faza e rekrutimit të PAE dhe PAK. Stafi akademik që aplikon për t'u angazhuar në mesimdhënie rekrutohet nëpërmjet një proces dinamik vlerësimi. 2. Përveç kriterëve dhe dokumentacionit përkatës ekspertiza dhe përvoja e aplikantit vlerësohet përmes një leksioni të hapur demo që teston njohuritë e tij/saj për konceptet, analizat teorike si dhe aftësia dhe metodat e mesimdhënies. 3. Verifikohet nëse stafi akademik është i specializuar në nëndisiplinën specifike në të cilën ata janë të angazhuar në mesimdhënie dhe janë kompetentë në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, duke përdorur metoda të ndryshme mesimore sipas temave dhe profileve. 4. Në kuadër të përmirësimit të mesimdhënies dhe të nxënës Komisioni i Përhershëm dhe NJSBC organizon trajnime e seminare të ndryshme. <p>Për të mundur një metodologji mesimore më efektive të bazuar në TIK, kompjuterët e klasës dhe kompjuterët e vendosur në laboratorë përmbajnë paketat e nevojshme për lëndët e këtij programi studimi. Duke iu referuar CV-ve të personelit akademik, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca kompjuterike" posedon përgatitje dhe kompetenca profesionale në mesimdhënie dhe në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Pjesë e personelit akademik të programit të studimit janë edhe ekspertë me eksperiencë në industri dhe administratë publike, me njohuri që lidhen dhe me kurrikulën e programit. Eksperiencia e tyre wshtw me vlerw nw mbwshtetjen dhe demonstrimin në auditor të rasteve reale të zbatimit të lidhura me fushën e studimit të shkencave kompjuterike.</p> <p>DVV Evidenca 67: CV te stafit akademik; DVV Evidenca shtesë: Minutat gjate vizites ne IAL; DVV Evidenca shtesë 5: Lista e Aplikacioneve te perdorura per MASTER ne Shkenca Komp; DVV Evidenca shtesë 12: pershkrimi i laboratorit.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mesimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Personeli akademik në KU "Bedër" plotëson formularin e anketave vetëvlerësuese që kontrollon nga përgjegjësi i departamentit përkatës. Gjithashtu rezultatet e anketimeve dhe vlerësimeve periodike të anketës vlerësuese të studentit për stafin akademik, ku përfshihen dhe format dhe metodat e mesimdhënies, i komunikohen çdo pedagogu në zarf të mbyllur. Stafi akademik përditëson syllabuset në fillim të vitit akademik ku reflekton dhe përmirësimin e formave e metodave të mesimdhënies. Ofrimi i ambienteve online ose fizike, si dhe intershipëve lëndore në lëndë specifike, që lejojnë realizimin e laboratorëve, detyrave, projekteve dhe punëve të ndryshme të pavarura inkurajojnë autonominë te studenti. Mesimdhënësit janë të pranishëm gjatë laboratorëve detyrave, projekteve</p>

	<p>dhe punëve të ndryshme të pavarura të cilat realizohen në vijim të pjesës teorike. GVJ konstatoi respekt të ndërsjellë ndërmjet mësimeve dhe studentëve gjatë vizitave në institucion.</p> <p><i>DVV Evidenca 70: Formular i vlerësimit për stafin akademik;</i> <i>DVV Evidenca 71: Raport përmbledhje vlerësimi për stafin akademik;</i> <i>DVV Evidenca 62: Formulari i "Anketës me të diplomuarit për programin e studimit;</i> <i>DVV Evidenca 60: Anketa e studentit ndaj lëndës.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimeve, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimeve. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimeve, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimeve dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Komisioni i Përbërshëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale (KPGSCI) dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në KU "Bedër" organizon dhe drejton përmirësimin e vazhdueshëm të mësimeve në nivel institucional. Kjo njësi ka rregulloren e saj, ku përcaktohet edhe mënyra e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë kryesore dhe bazë. Rezultatet e pyetësorit, të paraqitura të përmbledhura në raport dhe që i komunikohen individualisht personelit akademik, shërbejnë si bazë për përmirësimin e cilësisë së mësimeve. Stafi akademik plotëson formularin e vetëvlerësimit i cili dorëzohet në njësinë bazë, përpara se të vlerësohen më tej nga eprorët e tyre. DSHK realizon monitorimin e cilësisë për lëndët e ofruara nga programi edhe nëpërmjet anketës së lëndëve që plotësohet nga studentët. Kjo anketë mundëson gjithashtu rritjen e vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në mësime.</p> <p>KU "Bedër" inkurajon bashkëpunimin dhe ndarjen e eksperiencës të personelit të tij akademik dhe më gjerë. Duke pasur eksperiencë në ofrimin e programeve të edukimit dhe komunikimit ka qënë i mundur eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja inovative të mësimeve. KPGSCI dhe NJSBC organizojnë seminare dhe trajnime të ndryshme në kuadër të përmirësimit të cilësisë në mësime dhe në kërkimin shkencor.</p> <p><i>DVV Evidenca 55: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së;</i> <i>DVV Evidenca 56: Vendim senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përbërshme;</i> <i>DVV Evidenca 70: Formular i vlerësimit për stafin akademik;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 25: Formular i Vlerësimit të Vazhdueshëm të Mësimeve;</i> <i>DVV Evidenca 71: Raport përmbledhje vlerësimi për stafin akademik;</i> <i>DVV Evidenca 62: Formulari i "Anketës me të diplomuarit për programin e studimit;</i> <i>DVV Evidenca 60: Anketa e studentit ndaj lëndës;</i> <i>DVV Evidenca shtesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i> <i>DVV Evidenca 30: Lista e trajnimeve të stafit, viti akademik 2020-2022;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 15; Plani i aktiviteteve të NJSBC 2022-2023.</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca kompjuterike" zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale të miratuara nga IAL nëpërmjet rregulloreve specifike. KU "Bedër" angazhohet në mbështetjen e personelit akademik për përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike. DKSJ vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë dhe reflektuar mendimin e studentëve. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale (KPGSCI) dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në KU "BEDËR" organizojnë, drejtojnë dhe monitorojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel institucional dhe organizojnë seminare dhe trajnime të ndryshme në kuadër të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore, janë të përcaktuara në rregulloren themelore të KU "Bedër" dhe rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat u bëhen të njohura studentëve nëpërmjet sistemit BIS. <i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore</i> <i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 26: Syllabuset e Lendeve;</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët e programit të studimit u informua se syllabuset e lëndëve ruhen nga titullari i lëndës/modulit në sistemin BIS dhe studentët mund t'i shohin ato pas logimit në sistem, ku mund të marrin informacion mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Këto informacione ju komunikohen gjithashtu studentëve në fillim të semestrit nga pedagogu i lëndës dhe janë të publikuara në faqen e DSHK. <i>DVV Evidenca 43: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS);</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

34

	<i>DVV Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i> <i>DVV Evidenca: https://internal.beder.edu.al/sq/curriculum/38.</i>		
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive, plotësimi i detyrimeve, si laborator, detyrë apo projekt kursi, testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar. <i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore;</i> <i>DVV Evidenca shitesë 26: Syllabuset e Lendeve.</i>		
Konkluzione	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore, janë të përcaktuara në rregulloren themelore të KU "Beder" dhe rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Syllabuset e lëndëve ju vihen në dispozicion studentëve nga pedagogu i lëndës/modulit në sistemin BIS. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive, plotësimi i detyrimeve, si laborator, detyrë apo projekt kursi, testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale realizohet përgjatë vitit akademik me qëllim që studentët të jenë të angazhuar përgjatë semestrit dhe të vlerësohen sipas disa kriterëve të parashikuara në rregulloren themelore, në procedurat e vlerësimit të studentëve në funksion të përmbushjes së detyrimeve akademike dhe rritjes së cilësisë në mësimdhënie të udhëzimit dhe sipas kriterëve të parashikuara në syllabuset e lëndëve. Në përgjithësi, ka dy afate kohore të dedikuara për provimet afatmesme (java e 8-të e semestrit) dhe provimet përfundimtare (java 15 dhe 16-dy javët e fundit të semestrit). Midis provimeve studentëve u kërkohet të punojnë në projekte ose të bëjnë një prezantim, sipas çdo kursi, ose detyrat përkatëse siç janë përcaktuar në planprogramin e çdo lënde të ofruar në kurrikulat e programit të studimit. Ndërkohë sipas rregullores themelore të IAL, në vlerësimin përfundimtar të çdo lënde përfshihet minimumi një testim gjysmëfinal dhe ai final. <i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore, neni 78, pika 5;</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

35

	<p><i>DVV Evidenca 69: Udhëzim mbi mesimdhënien inovative;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 26: Syllabuset e Lendeve;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 2: Format provimi.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Forma kryesore e testimit elektronik në KU "Bedër" është "Google forms". Testimi mund të realizohet dhe me alternativa dhe vlerësimi i studentit të bëhet në mënyrë të automatizuar 100 % nga sistemi. Secili nga studentët mund të marrë në mënyrë individuale tezën dhe automatikisht vlerësimin e tij, bashkë me çelësin e përgjigjeve. KU "Bedër" disponon gjithashtu sistemin e brendshëm BIS, ku bëhet komunikimi individual dhe ruajtja e vlerësimeve të studentit sipas lëndëve përkatëse.</p> <p><i>DVV Evidenca 29: Udhëzim mbi mesimdhënien në distance;</i> <i>DVV Evidenca 43: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS).</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar bëhet në përputhje me rregulloren themelore dhe atë të provimeve të IAL dhe sipas disa kriterëve të parashikuara në syllabuset e lëndëve, ku në vlerësimin përfundimtar të çdo lënde përfshihet minimumi një testim gjysmëfinal dhe ai final.</p> <p><i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore, neni 78, pika 5;</i> <i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve te ciklit te dyte;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 26: Syllabuset e Lendeve;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 2: Format provimi.</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i komponentëve të vlerësimit përfundimtar shoqërohet me komente nga pedagogu/pedagogët e lëndës, ku qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin dhe cilësinë e punimeve të tyre. Shpallja e rezultateve shoqërohet me shpjegimet përkatëse të përgjigjeve të sakta dhe me çelësin e tezës së provimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit u konstatua që në rastet e nevojshme, pedagogu/pedagogët e lëndës janë të gatshëm të japin mbështetjen dhe sqarimet shtesë të nevojshme për studentët që e kërkojnë këtë.</p> <p><i>DVV Evidenca 29: Udhëzim mbi mesimdhënien në distance;</i> <i>DVV Evidenca 43: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS).</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në rregulloret përkatëse të KU "Bedër" si ajo themelore dhe e disiplinës të studentëve është e përcaktuar moslejimi dhe janë përcaktuar masat që merren nga njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik që të shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Detyrat e kursit dhe projektet kontrollohen për plagjiaturë me anë të platformave falas dhe pa pagesë. Testet e ndërmjetme dhe ai final administrohen nga prania në auditor e dy pedagogëve, të cilët janë përgjegjës për moslejimin e kopjimit.</p> <p><i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore, neni 78, pika 5;</i></p>

	<p><i>DVV Evidenca 33: Rregullorja e disiplinës së studentëve;</i> <i>DVV Evidenca 69: Udhezim mbi mesimdhënieën inovative.</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar bëhet në përputhje me rregulloren themelore dhe atë të provimeve të IAL dhe sipas disa kriterëve të parashikuara për komponentët e vlerësimit në syllabuset e lëndëve, ku në vlerësimin përfundimtar të çdo lënde përfshihet minimumi një testim gjysmëfinal dhe ai final. Dhënia e vlerësimeve të provimeve në KU "Bedër" bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre.</p> <p><i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore, neni 78, pika 5;</i> <i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 26: Syllabuset e Lendeve;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 2: Format provimi.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik u informuam se nëse studentët kishin paqartësi në lidhje me vlerësimin komunikonin në fillim me pedagogun/pedagogët e lëndës. Studenti në zbatim të rregullores së programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", në rast se ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve, të paraqesë një ankesë me shkrim sipas formularit përkatës të miratuar tek zyra e sekretarisë mësimore për rivlerësim.</p> <p><i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike";</i> <i>DVV Evidenca 39: Formular ankimimi;</i> <i>DVV Evidenca 21: Shembull ankimimi note.</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Ankimimi shqyrtohet nga një komisioni i cili ngrihet me vendim të Këshillit të Departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre anëtarësh. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. Kjo procedurë dokumentohet dhe arkivohet pranë departamentit. Gjatë vizitës në institucion GVB u shpreh se ka pasur raste ankimimi nga studentët për vlerësimin dhe këto raste janë trajtuar duke ngritur komisione rivlerësimi.</p> <p><i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike";</i> <i>DVV Evidenca 39: Formular ankimimi;</i> <i>DVV Evidenca 21: Shembull ankimimi note.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se IAL siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në rregullore, procedura dhe kriterë specifike, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit në çdo rast të kërkuar, të cilat u bëhen të njohura studentëve.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesësisht
			X

Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	GVJ konstaton se program i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" si objektiv të zhvillojë tek studentët një botëkuptim të thellë të shkencave kompjuterike, duke i gërshetuar me sa më tepër mbështetje praktike, si intershipet lëndore dhe praktika profesionale, në mënyrë që të përgatisë dhe aftësojë për tregun e punës individë të përgatitur profesionalisht për t'u përballur me kushtet e një tregu të hapur global në fushën e shkencave kompjuterike. Njohuritë që ofrohen nga ky program dhe kompetencat që studentët fitojnë përmes tij, u japin mundësinë të ndjekin edhe një karrierë kërkimore e akademike në një cikël më të lartë, për të rritur statusin e tyre profesional dhe përmbushjen e objektivave personale, të cilët angazhohen dhe në punën kërkimore të stafit të departamentit. <i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike";</i> <i>DVV Evidenca shtesë 26: Syllabuset e Lendeve.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Ky program studimi synon krijimin dhe zhvillimin e aftësive specifike dhe në fushën e teknologjisë së informacionit, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë gjuhën e huaj) dhe aftësi të tjera të vecanta kurrikulare si: <ul style="list-style-type: none"> • Metodot e kërkimit shkencor; • Menaxhim Projekti; • si dhe Sjellje Organizative. <i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike";</i> <i>DVV Evidenca shtesë 26: Syllabuset e Lendeve.</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.	Nga takimi me studentët e programit, rezulton se në fillim të semestrit, studentëve iu ofrohet informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës dhe rezultatet e pritshme. Metodot e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale ju bëhen të njohura studentëve, analizohen dhe vlerësohen në përfundim të lëndës. Në këtë mënyrë u vihen në vëmendje konceptet dhe çështjet më të rëndësishme, si dhe të orientohen studentët për aplikimin e tyre, si dhe detyrimet përmblylëse dhe vlerësimi i tyre sipas kriterëve të parashikuara dhe prezantuara në syllabuset e lëndëve. Një nga praktikatat eficientë të aplikuara në IAL janë praktikatat intershipet lëndore dhe ato profesionale në

	<p>kompani dhe institucione të ndryshme, të cilat janë mënyra më efektive për të zbatuar praktikisht njohuritë e marra gjatë zhvillimit të lëndëve. Nëpërmjet pyetësorëve të realizuar në fund të semestrit, IAL siguron informacion mbi cilësinë e aftësive që ata fitojnë. Gjithashtu vetë IAL realizon një analizë të provimeve përfundimtare dhe të rezultateve të studentëve, për të monitoruar kalueshmërinë, cilësinë, frekuentimin etj.</p> <p><i>DVV Evidenca 64: Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike”;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 26: Syllabuset e Lendeve;</i> <i>DVV Evidenca 44: Performanca e studentëve nga Zyra e Sekretarisë Mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ vlerëson se personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë dhe duke kryer praktika dhe testime laboratorike së bashku me studentët. Gjatë zhvillimit të orëve mësimore, studentët realizojnë prezantime apo detyra kursi dhe projekte të ndryshme të parashikuara dhe në syllabuset e të gjitha lëndëve. Studentët aplikojnë njohuritë e marra gjatë lëndëve në praktikat lëndore dhe profesionale.</p> <p>Gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët, GVJ evidentoi se personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Detyrat/projektet e kursit në lëndët përkatëse janë një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup për raste hulumtimi shkencor apo zbatimi reale, në të cilat personeli akademik nxit studentët që ta trajtojnë studimin dhe gjetjen e zgjidhjes së problemeve duke u organizuar në skuadër. Në planin strategjik të KU “Bedër” një zë të veçantë ka rritja e mundësive dhe e përvojave ndërkombëtare për studentët duke synuar kështu rritjen e vetëdijes kulturore të studentëve dhe duke mbështetur idetë inovative profesionale dhe kërkimore shkencore.</p> <p>KU “Bedër” ka ndërtuar ura komunikimi dhe bashkëpunimi me disa universitete në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese për rritjen e kapaciteteve të stafit akademik dhe studentëve, si psh Universiteti TorVergata në Itali dhe organizata amerikane CRDFGLOBAL e kërkimit shkencor në fushën e sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes kibernetike me fokus në shkëmbimin e eksperiencave akademike dhe trajnimin e lektorëve dhe të studentëve, si dhe në kuadër të Erasmus në Rumani, Kroaci dhe SHBA. KU “Bedër” ka aplikuar në thirrjet e reja të Erasmus+ dhe projekte të reja të kërkimit shkencor, <u>por aktualisht nuk ka projekte aktive.</u> Nga IAL duhet të shtohen angazhimi për zgjerimin e bashkëpunimeve me universitete apo institucione kërkimore brenda dhe jashtë vendit, kjo në</p>

	<p>funkcion të përfshirjes më të gjerë në projektet exchange dhe mobilitet të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p> <p><i>DVV Evidenca shtesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i> <i>DVV Evidenca 12: Plani strategjik Institucional;</i> <i>DVV Evidenca 22: Raporti vjetor i Departamentit;</i> <i>DVV Evidenca 21: Lista e bashkëpunimit dhe MOU;</i> <i>DVV Evidenca 20: Marreveshje bashkepunimi ne kuader Erasmus me Universitetet, Rumani, Kroaci, SHBA;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 9: Memorandum crdf project.</i> <i>DVV Evidenca Shtesë 2: Lista e marreveshjeve per vitin 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. Për vitin 2021-2022 e në vazhdim, DSHK ka hartuar dhe organizuar një plan aktivitetesh, ndër të cilat leksione të hapura, workshope dhe seminare mbi zhvillimet në fushë dhe jashtë strukturës së programit të studimit të personelit akademik (PAE dhe PAK) të programit të studimit dhe lektorë të ftuar nga universitete partnere apo ekspertë në industri, si dhe seanca demonstruese mbi aplikime teknologjike.</p> <p><i>DVV Evidenca 17: Vendim i Keshillit te Departamentit per miratimin e planit te aktiviteve;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 27: Pershkrimi i aktiviteve te njesise ne 3 vitet e fundit;</i> <i>DVV Evidencë: https://cmp.beder.edu.al/sh/neës/activities/albania-code-camp-2022-6/1837</i> <i>DVV Evidencë: https://cmp.beder.edu.al/sh/neës/announcements/leksion-i-hapur-per-studentet-e-masterit-me-teme-perdorimi-i-teknologjise-ne-kryerjen-e-kerkimit-/1868</i> <i>DVV Evidencë: https://cmp.beder.edu.al/sh/neës/announcements/leksion-i-hapur-me-teme-decentralized-ledger-technology-and-blockchain-nga-z-klevis-shkemi/1885</i> <i>DVV Evidenca shtesë 23: Trajnimet me prof Hung.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Në planin strategjik të KU "Bedër" një zë të veçantë ka rritja e mundësive dhe e përvojave ndërkombëtare për studentët duke synuar kështu rritjen e vetëdijes kulturore të studentëve dhe duke mbështetur idetë inovative profesionale dhe kërkimore shkencore. DSHK si njësi përgjegjëse nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve kërkimore dhe angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për studime e projekte me karakter kërkimor shkencor duke angazhuar personelin akademik me ekspertizën e duhur. Vlen të theksojmë se 2 studentë të programit të studimit janë punësuar dhe si asistentë lektorë. Në mënyrë specifike DSHK ka angazhuar stafin akademik dhe studentët në lidhje me realizimin e konferencës shkencore dhe revistës periodike të KU "Bedër", pjesëmarrjen në konferenca dhe</p>

	<p>organizon aktivitete të ndryshme në funksion të kërkimit shkencor dhe realizimit të objektivave të programit të studimit.</p> <p><i>DVV Evidencë 68: Rregullorja mbi projektet kërkimore shkencore</i> <i>DVV Evidencë: https://icibt.beder.edu.al/;</i> <i>DVV Evidencë: https://ejtb.beder.edu.al/;</i> <i>DVV Evidencë shtesë 17: Lista e konferencave dhe e botimeve te stafit dhe studenteve viti akademik 2021-2022.</i></p>								
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se njohuritë që ofrohen nga ky program dhe kompetencat që studentët fitojnë përmes tij, u japin mundësinë të ndjekin edhe një karrierë kërkimore e akademike në një cikël më të lartë, për të rritur statusin e tyre profesional dhe përbushjen e objektivave personale. KU "BEDËR" ka ndërtuar ura komunikimi dhe bashkëpunimi me disa universitete në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese për rritjen e kapaciteteve të stafit akademik dhe studentëve. Nga IAL duhet të shtohen angazhimi për zgjerimin e bashkëpunimeve me universitete apo institucione kërkimore brenda dhe jashtë vendit, kjo në funksion të përfshirjes më të gjerë në projektet exchange dhe mobilitet të stafit dhe studentëve të programit të studimit. DSHK ka organizuar leksione të hapura, workshope dhe seminare mbi zhvillimet e fundit në fushë dhe jashtë strukturës së programit të studimit të personelit akademik (PAE dhe PAK) të programit të studimit dhe lektorë të ftuar nga universitete partnere apo ekesptërë në industri, si dhe seanca demonstruese mbi aplikime teknologjike. DSHK ka angazhuar studentët në lidhje me realizimin e konferencës shkencore dhe revistës periodike të KU "BEDËR", pjesëmarrjen në konferenca dhe organizon aktivitete të ndryshme në funksion të kërkimit shkencor dhe realizimit të objektivave të programit të studimit.</i></p>								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet				X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet						
			X						

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	KU "Bedër" ka hartuar në rregulloren themelore të tij, një procedurë të posaçme ku përcaktohen detyrimet që duhet të përmbyllë studenti deri në diplomimin e tij. Punimi i diplomës zë 18 kredite dhe është lënda përmbyllëse e semestrit të katërt në këtë program studimi, që këtë vit akademik nxjerr të diplomuarit e parë. KU "Bedër" ka hartuar kërkesat e diplomimit që i bëhen të ditura studentit nga DSHK nëpërmjet kalendarit akademik dhe ky informacion publikohet në faqen e internetit të IAL, së

	<p>bashku me udhëzimet e përgatitjes së tezës, që publikohet në faqen e internetit të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike</p> <p><i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore, nenet 87-89;</i> <i>DVV Evidenca https://beder.edu.al/static/docs/alb_kalendari_akademik_2022_2023_master_3740.pdf</i> <i>DVV Evidenca: https://mco.beder.edu.al/pages.php?id=16;</i> <i>DVV Evidenca: https://mco.beder.edu.al/pages.php?id=17.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>KU "Bedër" ka hartuar një manual për përgatitjen e punimit të diplomës dhe kriteret e vlerësimit të punimit të diplomës. Studentët e programit të studimit Master i Shkencave "Shkenca Kompjuterike" diplomohen me punimin dhe mbrojtjen e një teze. Informacioni dhe udhëzimet për punimin e diplomës ofrohen në faqen zyrtare të internetit të departamentit dhe përcillen nga këshilltari akademik dhe DSHK. DSHK përcakton stafin akademik për udhëheqjen e diplomave, të cilët kanë rol kyç në mentorimin, kontrollin dhe vlerësimin e ecurisë së punimit deri në diplomim të studentit.</p> <p><i>DVV Evidenca 35: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës për studentët e ciklit të dytë;</i> <i>DVV Evidenca 36: Formati zyrtar për punimin e diplomës;</i> <i>DVV Evidenca: 37 Shembull formulari i vlerësimit të punimit të diplomës për programin Master.</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" nuk aplikon provim final për studentët që diplomohen.</p> <p>Pas përgatitjes, vlerësimit dhe aprovimit të diplomës nga udhëheqësi dhe departamenti, studenti duhet të prezantojë punimin në juri, e përbërë nga 3 lektorë, e cila vepron si komision që vlerëson punimin e diplomës me notë, minimumi kaluese. Në këtë program studimi të diplomuarit e parë dalin këtë vit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>DSHK ka përcaktuar stafin akademik për udhëheqjen e diplomave këtë vit akademik. Personeli akademik përgjegjës për mbikëqyrjen dhe udhëzimin e studentëve gjatë procesit të përgatitjes së punimit të diplomës janë këshilltari akademik dhe udhëheqësi i diplomës, të përcaktuar për këtë program studimi. Caktimi i udhëheqësve të diplomës nga KU "Bedër" përfshin edhe asistencën e tyre në analiza, teste, matje, etj, në fushën e punimit të temës së diplomës, në ambientet e IAL apo jashtë tyre. Ata udhëzojnë studentët në procesin e kryerjes së hulumtimit dhe shkrimit të punimit, garantimin e cilësisë së punimit dhe rezultateve, si dhe miratimin e punimit final të diplomës për tu prezantuar para komisionit të diplomimit. KU "Bedër" ka hartuar një udhëzues të miratuar për shkrimin dhe formatin e punimit të diplomës. Ky është viti i parë kur diplomohen studentët në këtë program studimi.</p> <p><i>DVV Evidenca 35: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës për studentët e ciklit të dytë;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	

	<i>DVV Evidenca 36: Formati zyrtar për punimin e diplomës;</i> <i>DVV Evidenca 37: Shembull formular i vlerësimit të punimit të diplomës për programin Master.</i>		
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Studentët vlerësohen me notë, që pasqyrojnë performancën e tyre kërkimore e shkencore në punimin e diplomës. <i>DVV Evidenca 37: Shembull formular i vlerësimit të punimit të diplomës për programin Master.</i>		
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, IAL pajis studentin me diplomën dhe suplementin e saj. Ky është viti i parë kur diplomohen studentët në këtë program studimi. KU "Bedër" ka aplikuar për regjistrimin e formatit të diplomës pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA). <i>DVV Evidenca shtesë 1: Aplikim për formën e diplomes.</i>		
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Kur studentët plotësojnë kërkesat e procedurës së diplomimit si: <ul style="list-style-type: none">• kërkesat për kredite ECTS dhe• kërkesat për notën mesatare minimale. Zyrtat përkatëse të KU "Bedër" përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentët dhe lëshohet diploma dhe suplementi i diplomës për studentët e diplomuar sipas afateve dhe rregulloreve. KU "Bedër" përcakton në rregulloren e arkivës ruajtjen për një periudhë të pacaktuar të një kopje të dokumentacionit të studentit, që sipas kërkesës mund të marrë informacione në vazhdim. <i>DVV Evidenca 40: Rregullorja e Arkivës, neni 6.</i>		
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KU "Bedër" ndjek një procedurë të qartë të detyrimit përmblylëse të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin e nevojshëm pas diplomimit, i cili arkivohet sipas rregullores së IAL.</i>		
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Përmirësohet pjesërisht	Përmirësohet kryesisht	Përmirësohet plotësisht
			X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë	Nuk aplikohet në këtë program studimi.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

43

mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nuk aplikohet në këtë program studimi.
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalenohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nuk aplikohet në këtë program studimi.
Konkluzione	Nuk aplikohet në këtë program studimi.
Shkalla e përmbushjes së standardit	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Kolegjin Universitar "Bedër", GVJ konstaton se nga zyra e Burimeve Njerëzore, si njëسيا përgjegjëse janë mbledhur dhe ruajtur të dhënat e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme) dhe administrativ të angazhuar me programin Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" dhe janë krijuar dosje personeli për secilin prej tyre.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

44

<p>programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Gjatë vizitës dhe takimit me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore u vlerësuan dosjet e personelit akademik të anëtarëve të personelit akademik të angazhuar me programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", nje pedagogu te jashtem dhe nje pedagogu te brendshem. GVJ konstaton se nga kjo zyrë janë mbajtur dhe ruajtur të dhëna për angazhimin e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme) sipas në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike".</p> <p><i>DVV Evidenca 67: Evidence no. 67 CV of Academic staff;</i> <i>DVV Evidenca 66: Procedura e punësimit të stafit;</i> <i>DVV Evidenca 10: Statusi i KUB.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vendosur në fuqi nga KU "Bedër" u konstatua se personeli akademik efektive mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Personeli akademik efektive mbulon 70% të orëve në auditor. Këto të dhëna janë paraqitur në tabelën e ngarkesës por dhe u konstantuan gjatë vizitës me stafin akademik dhe gjithashtu dhe shefin e Departamentit.</p> <p><i>DVV Evidenca 10: Statusi i KUB;</i> <i>DVV Evidenca shtesë 2: Tabela e ngarkeses.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>KU "Bedër" nga vizita e GVJ në zyrën e burimeve njerëzore dhe gjithashtu nga dokumentacionet e vendosura në dispozicion tregojnë që ka qëndrueshmëri të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Në zyrën e burimeve njerëzore u panë të dokumentacionet e stafit akademik dhe gjithashtu u konstantuan dosjet për stafin e jashtëm dhe të brendshëm. Pjesë e dosjeve ishin CV e stafit akademik, vërtetim diplomash, kontratat e punësimit, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, leje nga punëdhënësi për pedagogët e jashtëm, etj.</p> <p><i>DVV Evidenca 67: CV of Academic staff;</i> <i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore;</i> <i>DVV Evidenca 25: Rregullorja mbi organizimin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>KU "Bedër" ka paraqitur në dokumentacion që ndjek procedura të rekrutimit dhe të vlerësimit transparent në stafin akademik. Këto procedura janë paraqitur në statutin e KU "Bedër" ku kriteret e punësimit përcaktohen nga njësia bazë, kurse me pas kalojnë të miratohen nga dekani dhe rektori. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU "Bedër", GVJ konstaton se në procedurën e ndjekur për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik janë plotësisht të përfshirë departamenti i dhe Fakulteti përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" nëpërmjet:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • paraqitjes së kërkesës dhe kriterëve të përgjithshme dhe të posacme për plotësimin e vakancës/vakancave në përputhje me modulet dhe përmbajtjen e programit dhe kualifikimin e personelit të kërkuar; • përfaqësimit në shumicë të departamentit që mbulon programin në komisionin ad-hoc për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues të vakancës/vakancave. <p><i>DVV Evidenca 10: Statusi i KUB(neni 26, neni 61);</i> <i>DVV Evidenca 66: Procedura e punësimit të stafit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstantoi që KU “Bedër” ka siguruar angazhimin maksimal të personelit akademik të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike, mirëmbajtjen e laboratoreve dhe mjediseve të tjera mësimore. Gjatë vizitës me stafin akademik të angazhur u konstatua që një pjesë e orëve praktike janë realizuar direkte në kompanitë me të cilat kanë marreveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>DVV Evidenca shtese 22: Tabela e ngarkeses;</i> <i>DVV Evidenca 21: Lista e bashkëpunimit dhe MOU.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>KU “Bedër” ka paraqitur në dokumentacionin e tij përmbledhje të të dhënave akademike dhe përditësimit të tyre në çdo vit. Në këto të dhëna të cilat janë të dokumentuara dhe në zyrën e burimeve njerezore kanë përfshirë personelin akademik të angazhuar në programin e studimit dhe u konstatuan dhe gjatë vizitës së GVJ. Në fillim të vitit akademik dhe semestrit përcaktohet ngarkesa mësimore e çdo anëtari të personelit akademik.</p> <p><i>DVV Evidenca shtesë 22: Tabela e ngarkeses.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>KU “Bedër” ka marreveshje bashkëpunimi me disa institucione dhe kompani të cilat i ka paraqitur dhe në dokumentacionin në dispozicion të GVJ. Gjithashtu i ka vendosur rëndësi të vecantë praktikave profesionale të cilat janë vendosur në dispozicion nga kompanitë që kanë bashkëpunim dhe stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie.</p> <p>KU “Bedër” ka bërë marrëveshje bashkëpunimi për organizimin e konferencave ndërkombëtare të përbashkëta, projekteve të përbashkëta kërkimore, trajnimet profesionale etj., dhe me universitete në disa vende të europës. Në dokumentacione janë paraqitur dhe zhvillimi i leksioneve të hapura apo trajnimeve. Zyra e karrierës informon studentet për mundësitë e ndryshme që kanë studentët për punësim pas diplomimit dhe gjithashtu dhe trajnimet e ndryshme që mund ti ofrohen.</p> <p><i>DVV Evidenca 10: Lista e bashkëpunimit dhe MOU</i> <i>DVV Evidenca 6: Lista e stafit ne programe shkembimi;</i></p>

	<i>DVV Evidenca 3:Kompanite ku jane punesuar studentet e masterit te Shkenca Kompjuterike;</i> <i>DVV Evidenca 23: Trajnimet me prof Hung.</i>		
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	<p>KU "Bedër" ka njësi të vetën zyrën e karrierës e cila informon studentet për mundësitë e ndryshme që kanë studentët për punësim pas diplomimit dhe gjithashtu dhe trajnimet e ndryshme që mund ti ofrohen në kuader dhe të praktikave profesionale. KU "Bedër" ka caktuar dhe një staf përfaqësues që ndërlidh zyrën e karrierës me studentët dhe u mundëson dhe atyre vendin ku mund të bëhen dhe praktikat profesionale. Një pjesë e stafit të angazhuar në këtë department janë gjithashtu dhe pjesë e këtyre kompanive.</p> <p><i>DVV Evidenca 21: Lista e bashkëpunimit dhe MOU;</i> <i>DVV Evidenca 6: Lista e stafit ne programe shkembimi;</i> <i>DVV Evidenca 3: Kompanite ku jane punesuar studentet e masterit te Shkenca Kompjuterike;</i> <i>DVV Evidenca 18: Vendimi i Keshillit te Departamentit per perfaqesuesin ne zyrën e karrieres.</i></p>		
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se nga zyra e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse janë mbledhur dhe ruajtur të dhënat e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme) dhe administrativ të angazhuar me programin Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" dhe janë krijuar dosje personeli për secilin prej tyre. KU "Bedër" ka paraqitur në dokumentacion që ndjek procedura të rekrutimit dhe të vlerësimit transparent në stafin akademik. KU "Bedër" ka njësi të vetën zyrën e karrierës e cila informon studentet për mundësitë e ndryshme që kanë studentët për punësim pas diplomimit dhe gjithashtu dhe trajnimet e ndryshme që mund ti ofrohen në kuader dhe të praktikave profesionale.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	KU "Bedër" ka mjediset të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore. Ambientet kanë dy godina kryesore dhe ku përfshihen dhe ambientet e jashtme dhe postet e parkimit të cilat janë marrë me kontratë qiraje deri në vitin 2028. Përveç klasave të leksioneve dhe seminareve ka dhe dy laboratorë me kompjutera për zhvillimin e procesit mësimor dhe një laborator për multimedia. Në dispozicion të studenteve është dhe biblioteka. Në të cilën ka dhe disa poste për bibliotekën online.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@asca.lal

Web site: www.asca.lal

47

	<p><i>DVV Evidenca 5: Mjediset e Fakultetit/Njesise Baze (tabela 16);</i> <i>DVV Evidenca 4: Kontrate qiraje;</i> <i>DVV Evidenca 13: Plan Projekt Godina 2;</i> <i>DVV Evidenca 14: Plan Projekt Godina 1.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>KU "Bedër" ka mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore. Në godinen B2 ndodhen dhe ambientet kryesore që përdoren për programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike. Ambientet salla leksionesh, seminaresh dhe laboratorët në të cilat ndodhen të gjitha mjetet didaktike të nevojshme për procesin mësimor. Në funksion të programit të studimit ka dhe dy laboratorë të përshtatshëm të pajisur me kompjutera funksional dhe me të gjithë softëare-ët e nevojshëm për këtë program studimit. Laboratori 1 ka 27 poste pune kurse laboratorit 2 ka 24 poste pune. Ndodhet dhe një laborator për Multimedian me të gjitha pajisjet që mund të zhvillojnë mesim dhe studentët e masterit.</p> <p><i>DVV Evidenca 41: Specifikime teknike për laboratorin kompjuterave;</i> <i>DVV Evidenca 5: Mjediset e Fakultetit/Njesise Baze (tabela 16).</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>KU "Bedër" në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike ka laboratorë të përshtatshëm të pajisur me kompjutera funksional dhe me të gjithë softëare-et e nevojshëm për këtë program studimit. Laboratori 1 ka 27 poste pune kurse laboratorit 2 ka 24 poste pune. Ndodhet dhe një laborator për Multimedian me të gjitha pajisjet që mund të zhvillojnë mesim dhe studentët e masterit. Kompjuterat e përdorur në laboratorë janë ëorkstation me parametra teknike të larta të cilat kanë mundësi për përvetësimin praktike të aplikimeve që mund të kenë lëndët përkatëse. IAL duhet të konsolidojë mjediset profesionale, ku studentët kryejnë praktikatat e nevojshme në lidhje me programin e studimit.</p> <p><i>DVV Evidenca 41: Specifikime teknike për laboratorin kompjuterave;</i> <i>DVV Evidenca 12: Përshkrimi i laboratorit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>KU "Bedër" në funksion të programit të studimit ka dhe laboratorë të përshtatshëm të pajisur me kompjutera funksional dhe me të gjithë softëare-et e nevojshëm për këtë program studimi. Laboratori 1 ka 27 poste pune kurse laboratorit 2 ka 24 poste pune. Kompjuterat e përdorur në laboratore janë ëorkstation me parametra teknike të larta të cilat kanë mundësi për përvetësimin praktikë të aplikimeve që mund të kenë lëndët përkatëse. Në dokumentacion institucioni ka paraqitur përshkrimet teknike të kompjuterave dhe të programeve që përdoren, të cilat janë sipas natyrës së programit të studimit.</p> <p><i>DVV Evidenca 41: Specifikime teknike për laboratorin kompjuterave;</i> <i>DVV Evidenca 12: Përshkrimi i laboratorit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione</p>	<p>Nga vizita e GVJ dhe dokumentacionet në dispozicion që ka paraqitur institucioni, KU "Bedër" i ka të gjitha kapacitetet e nevojshme për praktikatat</p>

<p>dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>mësimore të programit të studimit. Gjithashtu ka dhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera për praktikat profesionale të cilat mund të bëhen dhe në ambientet e kompanive. KU Beder ka paraqitur në dokumentacion një listë me kompanitë me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Për zhvillimin e praktikave rolin e ndërmjetësit me studentet e bën Zyra e Karrierës dhe një perfaqësues nga departamenti, në ndihmë të gjetjes së praktikave më të mira dhe qasjes së studenteve në tregun e punës.</p> <p>DVV Evidenca 18: Vendimi i Keshillit të Departamentit për perfaqësuesin në zyrën e karrierës; DVV Evidenca 21: Lista e bashkëpunimit dhe MOU; DVV Evidenca 34: Formular aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale.</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe nga vizita në institucion, GVJ konstanton se KU "Beder" ka mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore. Ambientet kanë dy godina kryesore dhe ku përfshihen dhe ambientet e jashtë dhe postet e parkimit të cilat janë marrë me kontratë qiraje deri në vitin 2028. Ambienti ku zhvillohet mësimi për programin Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" është i përshtatshëm për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve me të gjitha mjetet didaktike. Në godinë ndodhen dhe dy laborator të kompletuar me softëare-t e nevojshëm dhe kompjutera me parametra të një workstation për zhvillimin e orëve të laboratorit dhe praktikave mësimore. IAL duhet të konsolidojë mjediset profesionale ku studentët kryejnë praktikat e nevojshme në lidhje me programin e studimit.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="558 1209 766 1299">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="766 1209 989 1299">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="989 1209 1181 1299">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1181 1209 1394 1299">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjubën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe vizitës në ambientet e KU Beder u kontaktua se në dispozicion të studenteve është vendosur e gjithë literatura e nevojshme bazë dhe ndihmëse për të gjitha lëndët që zhvillohen në programin e studimit Msc në Shkenca Kompjuterike. Lektorit i lëndës zgjedh literaturën dhe ia paraqet studenteve në orën e parë të leksionit. Komunikimi i literaturës bëhet në mënyrë dixhitale dhe studenteve u jepet një kopje elektronike dhe fizike. Kopje e literaturave janë dhe në bibliotekë në të cilën kanë në dispozicion dhe platformat online. Për platformat online</p>

	<p>përdoret JSTOR, marrveshja e të cilës është paraqitur dhe në dokumentacionet e vendosura ne dispozicion nga institucioni.</p> <p><i>DVV Evidenca 6: Te dhenat e plota per platformen online;</i> <i>DVV Evidenca 42: Marrveshja për akses në JSTOR;</i> <i>DVV Evidenca 8: Literatura e Programit te studimit master i Shkencave ne Shkenca Komp.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike është Departamenti Shkencave Kompjuterike. Në fillim të vitit akademik i kërkohet lektorëve që të bëhet përditësimi i syllabuseve të lëndëve dhe përditësimet e literaturave përkatëse. Më pas këto i kalojnë rektoratit dhe bibliotekës për të plotësuar nevojat me literature e kërkuar. Ne dokumentacionin e vendosur ne dispozicion nga GVB per KU Beder dhe programin e studimit Msc ne Shkenca Kompjuterike, GVJ ka konstantuar se jane vendosur te dhenat e syllabuseve te lendeve dhe gjithashtu dhe te dhenat e bibliotekes, marrveshja me JSTOR etj.</p> <p><i>DVV Evidenca 26: Silabuset e Lendëve;</i> <i>DVV Evidenca 42: Marrveshja për akses në JSTOR.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>KU Bedër ka vendosur në dispozicion të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" dhe vizita e bërë në ambientet bibliotekës së institucionit u konstantua se biblioteka është në dispozicion të studentëve për përdorimin fizik, studim dhe gjithashtu dhe për përdorimin e bibliotekës online. Ajo ka aktualisht 6 poste me kompjuter për përdorimin dhe të bibliotekës online dhe 35 poste për lexim. Biblioteka mund të shfrytëzohet nga të gjithë studentët në mënyrë të barabartë. Gjithashtu biblioteka online JSTORE mund të aksesohet kudo.</p> <p><i>DVV Evidenca 42: Marrveshja për akses në JSTOR;</i> <i>DVV Evidenca 29: Procedurat e pasurimit të bibliotekës.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikkës së programit të studimit.</p>	<p>KU Bedër ka vendosur në dispozicion të programit të studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike Bibliotekën, në të cilën ndodhen fizikisht 35 poste per lexim, 6 poste me kompjuter. Biblioteka është e pasur me tekste mësimore ne gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Ajo pasurohet çdo vit me literature e re të rekomanduar me tekstet përkatëse dhe nëse tekstet nuk janë fizikisht ne bibliotekë studentet mund ti gjejnë dhe online në JSTORE. Institucioni ka vendosur në dispozicion të studenteve dhe stafit një program për menaxhimin e bibliotekës dhe për kërkimin e teksteve të ndryshme në bibliotekë.</p> <p><i>DVV Evidenca 42: Marrveshja për akses në JSTOR;</i> <i>DVV Evidenca 29: Procedurat e pasurimit të bibliotekës;</i></p>

	<i>DVV Evidenca 8: Literatura e Programit te studimit master i Shkencave ne Shkenca Komp.</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga GVB dhe në vizitën që u bë në institucion, GVB konstanton se KU Bedër ka vendosur në dispozicion të studenteve dhe stafit akademik që nga viti akademik 2013 një abonim me database elektronik online që të kenë mundësi që ti sigurojnë materialet dhe në formë elektronike. Biblioteka është falas për të gjithë studentët e këtij programi të studimit. Gjithashtu në dispozicion kanë dhe bibliotekën online të JSTORE. <i>DVV Evidenca 42: Marrëveshja për akses në JSTOR;</i> <i>DVV Evidenca 29: Procedurat e pasurimit të bibliotekës.</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	KU Bedër ka siguruar që studentët të kenë akses në bibliotekë dhe në poste me kompjuter. Ka 6 poste me kompjuter që mund të aksesojnë bibliotekën online por gjithashtu dhe për navigim në internet. Grupi i GVJ bëri vizitën në bibliotekë dhe pati mundësi që të shikonte dhe ambientet. <i>DVV Evidenca 42: Marrëveshja për akses në JSTOR;</i> <i>DVV Evidenca 29: Procedurat e pasurimit të bibliotekës.</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e institucionit KU Bedër është në dispozicion të studentëve gjatë orareve të shërbimit, kryesisht nga ora 8.30 deri në orën 19:00, kurse gjatë periudhave të provimeve biblioteka qëndron e hapur dhe në fundjave. Ajo disponon vende të mjaftueshme për studentet gati deri në 35 poste pune dhe postet me kompjuter. Institucioni ka vendosur në dispozicion dhe sistemin e automatizimit në të cilin bëhet kërkesa për literaturë dhe regjistrimi i studentëve. Sistemi i menaxhimit të bibliotekës dhe mënyra e organizimit të bibliotekës u konstantuan dhe gjatë vizitës së GVJ në institucion. <i>DVV Evidenca 42: Marrëveshja për akses në JSTOR;</i> <i>DVV Evidenca 29: Procedurat e pasurimit të bibliotekës;</i> <i>DVV Evidenca 43: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS).</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij	Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga GVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstantoi se KU Bedër ka paraqitur se përveç teksteve të cilat kërkohen çdo vit për pasurimin e literaturës në dispozicion të studentëve nga marrëveshjet online ka patur herë pas herë dhe fushata sensibilizuese për pasurimin fizik të librave të bibliotekës. Gjithashtu çdo departament ka fonde vjetore për të bërë blerje në bibliotekë të literaturave përkatëse. Në dokumentacion janë paraqitur procedurat që ndjek institucioni për pasurimin e bibliotekës. GVJ ka konstantuar një numër të kufizuar të teksteve fizike për literaturën bazë dhe të rekomanduar në bibliotekë për programin e studimit. <i>DVV Evidenca 29: Procedurat e pasurimit të bibliotekës;</i> <i>DVV Evidenca 42: Marrëveshja për akses në JSTOR;</i>

online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	DVV Evidenca 8: Literatura e Programit të studimit master i Shkencave në Shkenca Komp.			
Konkluzione	<i>GVJ konstantoi se biblioteka e institucionit KU Bedër është në dispozicion të studentëve gjatë orareve të shërbimit, kryesisht nga ora 8.30 deri në orën 19:00, kurse gjatë periudhave të provimeve biblioteka qëndron e hapur dhe në fundjavë. Ajo disponon vende të mjaftueshme për studentet gati deri në 35 poste pune dhe postet me kompjuter. Institucioni ka vendosur në dispozicion dhe sistemin e automatizimit në të cilin bëhet kërkesa për literaturë dhe regjistrimi i studentëve. GVJ rekomandon se IAL duhet të hartojë dhe zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues për programin e studimit Msc në "Teknologji Informativ dhe Inovacioni" sipas nevojave dhe kërkesave për këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	KU "Bedër" disponon një sistem të brendshëm të administrimit institucional të cilin e ka paraqitur dhe në dokumentacionet që ka dorëzuar por u konstantua dhe nga grupi i GVJ gjatë vizitës në institucion. Sistemi që përdor KU "Bedër" është sistemi BIS. Në këtë sistem ka llogari stafi administrative dhe akademik që u vihet në dispozicion nga zyra IT në momentin që fillojnë punë. Në këtë sistem janë të ruajtura të gjitha të dhënat e studenteve nga momenti i regjistrimit deri në diplomim dhe janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat e tyre. DVV Evidenca 43: Udhëzues i Sistemit Informativ "Bedër" (BIS).
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	KU "Bedër" ka në përdorim një sistem të brendshëm për menaxhimin dhe administrimin e informacionit. Sistemi që përdor KU "Bedër" bën të mundur që të gjitha të dhënat të administrohen si për stafin dhe për studentet në mënyrë automatike. Të gjitha njësitë kanë një llogari faqe të tyre ku bëhen të gjitha veprimet e njësive. Disa nga njësitë që kanë llogari janë: Studentët, stafi akademik, zyra e burimeve njerëzore, Sekretaria mësimore, biblioteka, Zyra financës, zyra e Mardhënies me Publikun, etj. Në këtë sistem bëhet gjithashtu dhe gjurmimi i të gjitha aktiviteteve të njësive. DVV Evidenca 43: Udhëzues i Sistemit Informativ "Bedër" (BIS).

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr.219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

52

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstantoi dhe sistemin e përdorur nga KU "Bedër" për menaxhimin e informacionit të institucionit. I gjithë stafi akademik dhe ndihmës akademik dhe administrative kanë mundësi që të futen në këtë sistem me akses të dedikuar. Çdo njësi ka një llogari, faqe të tyre, ku bëhen të gjitha veprimet e njësisë.</p> <p><i>DVV Evidenca 43: Udhëzues i Sistemit Informativ "Bedër" (BIS).</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur që sistemi BIS ka të integruar platforma dhe module që lejojnë që stafi akademik dhe studentët të kenë mundësi për të shkëmbyer informacionet ndërmjet tyre.</p> <p>Në këtë sistem ka llogari stafi administrative dhe akademik që u vihet në dispozicion nga zyra IT në momentin që fillojnë punë. Në këtë sistem janë të ruajtura të gjitha të dhënat e studentëve nga momenti i regjistrimit deri në diplomim dhe janë pasqyruara në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat e tyre. Në sistem bëhet i mundur dhe qarkullimi i informacionit në kohë reale nga njëra njësi tek tjetra.</p> <p><i>DVV Evidenca 43: Udhëzues i Sistemit Informativ "Bedër" (BIS).</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>KU "Bedër" ka paraqitur që sistemi që përdorin për shkëmbimin e informacionit bën të mundur dhe monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrative. Në fillim të simestrit studentët mund të paraqesin plotësojnë lëndët që kanë zgjedhur. Gjithashtu në sistem paraqitet dhe vlerësimi i studentëve dhe procedurat e të gjitha njësive të tjera.</p> <p><i>DVV Evidenca 43: Udhëzues i Sistemit Informativ "Bedër" (BIS).</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>KU "Bedër" i ka paraqitur informacionet që lidhen me programin e studimit në faqen zyrtare të institucionit. Informacioni është i paraqitur në anglisht dhe në shqip, ka paraqitur gjithashtu informacion për programin e studimit, për stafin akademik përgjegjës dhe aktivitete të ndryshme të institucionit. Mundësi për tu futurë në bibliotekën e JSTOR, sistemin e menaxhimit BIS dhe aplikimi online për programin e studimit dhe bursën.</p> <p><i>DVV Evidenca: https://www.beder.edu.al/;</i> <i>DVV Evidenca: https://www.beder.edu.al/sh/content/default/administri-mi-i-institucionit-14-9/4/140.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ nga evidencat e sjella në dokumentacion dhe gjithashtu nga vizita e bërë në institucion ka parë që KU "Bedër" përdor një sistem të brendshëm për menaxhimin e informacionit. Në këtë sistem kanë llogari të gjithë stafi akademik, administrative dhe studentët. Informacioni në këtë sistem mund të shpërndahet në kohë reale dhe mund të lejojë që njësitë të komunikojnë me njëra tjetrën. Informacionet në lidhje me programin e studimit janë paraqitur dhe në faqen e web-it të institucionit në anglisht dhe në shqip. Në faqen e web-it janë paraqitur dhe mundësia për tu futurë në faqen e BIS,</p>

	<i>bibliotekën JSTORE dhe aplikime online për pranimin e programi dhe bursave.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>KU "Bedër" ka hartuar raport financiare të kostove të njësisë përgjegjëse për programin e studimit në të cilin janë paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet e programit të studimit.</p> <p>KU "Bedër" gëzon statusin e një institucioni të lartë arsimor jofitimprurës. Mbështetje të madhe për institucionin janë dhe donacionet. KU "Bedër" ka paraqitur që ka të ardhura të mjaftueshme për mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p><i>DVV Evidenca 10: Statusi i KUB;</i> <i>DVV Evidenca 13: Mbeshtetja financiare per studentet nga trevat;</i> <i>DVV Evidenca 7: Te ardhurat dhe financimet e ndryshme ne 3 vitet e fundit (tabela 18).</i></p>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të	<p>Intitucioni KU "Bedër" ka paraqitur në evidencat raportin financiar të tre viteve të fundit ku janë paraqitur të detajuara të ardhurat dhe shpenzimet. Në raport paraqiten granetet e marra dhe shpenzimet e bëra si pagat e personelit, për bibliotekën etj. Në pasqyren financiare është përfshirë dhe plani financiar i njësisë bazë për programin e studimit i cili përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të progamit, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literatures e aksesin në bibliotekën online etj.</p> <p><i>DVV Evidenca 7: Te ardhurat dhe financimet e ndryshme ne 3 vitet e fundit (tabela 18).</i> <i>DVV Evidenca 65: Projektbuxheti;</i> <i>DVV Evidenca 11: Pasqyra financiare.</i></p>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	<p>KU Bedër ka paraqitur auditim periodik financiar për vitin 2021 nga një kontabilist i miratuar. Në dokumentacionin e dorëzuar është paraqitur dhe pasqyra financiare.</p> <p><i>DVV Evidenca 11: Pasqyra financiare;</i> <i>DVV Evidenca 65: Projektbuxheti.</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>KU Bedër ka paraqitur raportet financiare të veta të detajuara deri në njësinë bazë të programit të studimit. Mbi realizimin e buxhetit te plotë duke qënë se është institucion jofitimprurës. Gjithashtu në dokumentacion është paraqitur dhe projektbuxheti.</p> <p><i>DVV Evidenca 11: Pasqyra financiare;</i> <i>DVV Evidenca 65: Projektbuxheti.</i></p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga GVB dhe nga vizita në institucion, GVB konstanton që institucioni ka patur qëndrueshmëri financiare. Gjithashtu dhe për programin e studimit Msc në Shkenca Kompjuterike, u konstantua gjithashtu dhe nga takimet me studentët që një pjesë e studentëve i vazhdojnë studimet me bursa. Ai deklaron që të ardhurat janë nga tarifa e studimit, donacionet, etj. Megjithatë vetëm të ardhurat e deklaruar nuk e sigurojnë qëndrueshmërinë financiare në vazhdim.</p> <p>Bazuar ne statistikata e paraqitura të numrit jo të lartë të regjistrimeve dhe me një ulje të studenteve të regjistruar në vitin 2022-2023 (viti 1 ka 12 studentë dhe viti 2 ka 7 studentë) dhe ka patur burim kryesor të të ardhurave të institucionit pagesat nga tarifat e studimit. Vlerësohet se ky program studimi paraqet riskun e paqëndrueshmërisë financiare në vazhdim. Për këtë arsye IAL duhet të angazhohet për gjetjen e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit.</p> <p><i>DVV Evidenca 11: Pasqyra financiare;</i> <i>DVV Evidenca 65: Projektbuxheti.</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ ka verejtur nga dokumentacioni i paraqitur dhe nga vizita ne ambientet e KU Beder qe institucioni ka dokumentacion te plote dhe te detajuar per te ardhurat financiare. Në dokumentacion janë paraqitur raportet financiare institucionale, pasqyra financiare, projektbuxheti. Etj.GVJ rekomandon që IAL të angazhohet për gjetjen e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyhet plotësisht</th> <th>Përmbyhet kryesisht</th> <th>Përmbyhet pjesërisht</th> <th>Nuk përmbushet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet pjesërisht	Nuk përmbushet		X		
Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet pjesërisht	Nuk përmbushet						
	X								

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyhet plotësisht</th> <th>Përmbyhet kryesisht</th> <th>Përmbyhet pjesërisht</th> <th>Nuk përmbushet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet pjesërisht	Nuk përmbushet		X		
Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet pjesërisht	Nuk përmbushet						
	X								

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>GVJ nga vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar, ka konstatuar që KU "Beder" ka hartuar politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me ligjin nr. 80/2015 "Për arësimin e lartë dhe kërkimin shkencor në insitucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Këto procedura u paraqiten dhe studenteve të këtij programi studimi me anë të sistemit BIS.</p> <p><i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore;</i> <i>DVV Evidenca 25: Rregullorja mbi organizimin akademik;</i> <i>DVV Evidenca 48: Shembull, kontratë student.</i></p>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	<p>KU Beder ka paraqitur ne dokumentacion qe ndjek politika dhe procedura qe garantojne te drejta te barabarta per studentet nga hyrja e studenteve deri ne perfundim te studimeve.</p> <p><i>DVV Evidenca 44: Performanca e studentëve nga Zyra e Sekretarisë Mësimore;</i> <i>DVV Evidenca 45: Guida e Studentit;</i> <i>DVV Evidenca 48: Shembull, kontratë student.</i></p>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konfirmon se në zbatim të politikave dhe procedurave të Institucionit ka përdorur një sërë mjetesh dhe metodash bashkëkohore për publikimin e kritereve dhe procedurave të aplikimit, pranimit dhe regjistrimit të studentëve, procesit të vlerësimit të dijeve si dhe diplomimit të studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Kriteret dhe procedura e aplikimit janë publikuar përpara fillimit të vitit akademik në faqen zyrtare të institucionit, në fushatat informuese mediatike të zhvilluara në shkolla të mesme të ndryshme jo vetëm të Tiranës, broshurat informuese, si dhe gjatë procesit të informimit dhe këshillimit në zyrat përkatëse në Institucion.</p> <p>KU Beder ka paraqitur ne dokumentacion Vendimet e senatit akademik per kriteret e pranimit te cilat jane si me poshte: 1) Mesatarja e shkolles se mesme per te gjitha vitet 70%, 2) Intervista nga komisioni vleresimit deri ne 30%, 3) Kushti per te mbrojtur nje nga gjuhet e huaja te percaktuara ne ushezimi nr.52 date 03.12.2015. Me pas keto procedura i dergohen Ministrise se arsimit dhe publikohen ne faqen e internetit.</p> <p><i>DVV Evidenca 28: Vendim Senati mbi kriteret e pranimit të studentëve;</i></p>

	<p><i>DVV Evidenca 46: Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programet e studimit "Master i Shkencave" në "Shkenca Kompjuterike";</i></p> <p><i>DVV Evidenca 47: Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në programin Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike.</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder GVJ konstaton se në zbatim të përcaktimit nenit 5 të Rregullores së Programit ka përcaktuar kriteret specifike të pranimit të studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Këto kriteret të veçanta për pranimin janë publikuar në faqen zyrtare të Web të KU Beder dhe u janë komunikuar para fillimit të vitit akademik studentëve dhe të interesuarve në zyrat përkatëse të institucionit.</p> <p><i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore, neni 58;</i></p> <p><i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë;</i></p> <p><i>DVV Evidenca 46: Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programet e studimit "Master i Shkencave" në "Shkenca Kompjuterike".</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ ka konstatuar se institucioni përpara fillimit të vitit për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" ka informuar dhe udhëzuar publikun dhe studentët e interesuar për kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin në programin e studimit nëpërmjet informimit në faqen Web të institucionit, fushata informuese dhe panaiereve, broshurave të informimit, si dhe informimit të publikut të interesuar dhe në zyrat dhe ambientet e institucionit.</p> <p><i>DVV Evidenca: https://www.beder.edu.al/sh/content/default/plani-strategjik-2018---2023-18/4/662;</i></p> <p><i>DVV Evidenca 46: Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programet e studimit "Master i Shkencave" në "Shke."</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>KU Beder ka paraqitur në dokumentacion kriteret e veta të përzgjedhjes së kandidatëve në këtë program studimi. Një pjesë e kuotave të veçanta janë dhe për studentet me aftësi të kufizuara, gjithashtu dhe për studentet nga trevat. Në dokumentacion kemi dhe vendimet e senatit akademik.</p> <p><i>DVV Evidenca 46: Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programet e studimit "Master i Shkencave" në "Shke";</i></p>

	<p><i>DVV Evidenca 47: Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në programin Master i Shkencave në Shkencë Kompjuterike;</i></p> <p><i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>KU Beder ka paraqitur në dokumentacion kriteret e veta të përzgjedhjes së kandidatëve në këtë program studimi. Një pjesë e kuotave të vecanta janë dhe për studentet me aftësi të kufizuara, gjithashtu dhe për studentet nga trevat. Në dokumentacion kemi dhe vendimet e senatit akademik. Një evidencë tjetër është dhe mbështetja financiare që i ofrohet studenteve nga trevat.</p> <p><i>DVV Evidenca 13: Mbështetja financiare për studentet nga trevat;</i></p> <p><i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>KU Beder duke qenë se ka fituar dhe statusin si një institucion jofitimprues. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ ka konstatuar se institucioni ofron bursa dhe mbështetje të ndryshme për studentet e këtij programi studimi.</p> <p><i>DVV Evidenca 13: Mbështetja financiare për studentet nga trevat;</i></p> <p><i>DVV Evidenca 7: Lista e studenteve Master që kanë përfituar zbritje të tarifës së studimit.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ nga vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar ka parë që KU Beder ka hartuar politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plote akademik të studenteve nga hyrja në dalje në përputhje me ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Këto procedura u paraqiten dhe studenteve të këtij programi studimi me anë të sistemit BIS. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ ka konstatuar se institucioni ofron bursa dhe mbështetje të ndryshme për studentet e këtij programi studimi. GVJ ka konstatuar se institucioni përpara fillimit të vitit për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkencë Kompjuterike" ka informuar dhe udhëzuar publikun dhe studentët e interesuar për kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin në programin e studimit nëpërmjet informimit në faqen Web të institucionit, fushata informuese dhe panaiereve, broshurave të informimit, si dhe informimit të publikut të interesuar dhe në zyrat dhe ambientet e institucionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" ka vënë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik në javën e parë të orientimit të organizuar nga fakulteti dhe me pjesëmarrjen e stafit akademik që mbulon programin në fjalë, si dhe gjatë orientimit dhe prezantimit të syllabusit të lëndës, nga çdo pedagog, në javën e parë të mësimin.</p> <p><i>DVV Evidenca 45: Guida e Studentit;</i> <i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve te ciklit te dyte;</i> <i>DVV Evidenca 48: Shembull, kontratë student;</i> <i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se institucioni në zbatim të Udhëzimit Nr.18, datë 21.05.2019, të ndryshuar të MASR, ka parashikuar procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Njohja e plote ose e pjesshme behet me ane te nje komisioni te zgjedhur per zgjedhjen dhe pranimin e studenteve me tre antare nga keshilli i departamentit. Ne rastin e ekuivalentimit studentet diplomohen vete, pasi kane kryer te pakten dy simestre ne Beder.</p> <p><i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve te ciklit te dyte;</i> <i>DVV Evidenca 48: Shembull, kontratë student;</i> <i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore;</i> <i>DVV Evidenca 49: Vendimi për ngritjen e Komisionit për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Studentëve;</i> <i>DVV Evidenca 27: Rregullorja për transferimin e studimeve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se institucioni në zbatim të përcaktimeve në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" ka informuar studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve të programit, në mënyrë të përgjithshme për infrastrukturën në dispozicion të programit në javën e orientimit dhe në mënyrë specifike gjatë prezantimit të secilës lëndë dhe syllabusit përkatës</p>

	<p>ku paraqitet ky informacion. Gjithashtu studenteve u jepen llogarite per tu futur ne sistemin BIS, ne te cilin gjendet ecuria dhe vazhdimesia e te gjitha lendeve qe studenti ka zgjedhur per te gjithë periudhen e studimeve, notat dhe piket e seciles lende. etj.</p> <p><i>DVV Evidenca 26: Silabuset e Lendëve;</i> <i>DVV Evidenca 43: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS);</i> <i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve te ciklit te dyte;</i> <i>DVV Evidenca 30: Shembull Orari mesimor (tt.beder.edu.al).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se institucioni në zbatim të përcaktimeve rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" ka informuar studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Studentet mund te zgjedhin nje provim formues ose nje punim diplome. Studenteve qe do te kryejne nje punim diplome u caktohet nje udheheqes me te cilin kryejne ne menyre te detyrueshme seanca konsultimi.</p> <p><i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve te ciklit te dyte;</i> <i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore;</i> <i>DVV Evidenca 35: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës për studentët e ciklit të dytë;</i> <i>DVV Evidenca 36: Formati zyrtar për punimin e diplomës.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder GVJ konstaton se përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni publikon dhe informon mbi programin e studimit, Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" në faqen zyrtare të internetit të institucioni, botimit dhe shpërndarjes së broshurave informuese, pjesmarrjes ne panaiire, organizimi i takimeve te drejtperdrejta dhe informacioni të dhënë gjatë vizitave të të interesuarve në institucion etj.</p> <p><i>DVV Evidenca: https://www.beder.edu.al/sh/content/default/informacion-i-pergjithshem-3/4/135</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" ka vënë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik te cilat jane paraqitur dhe ne dokumentacionet perkatese dhe ne faqen e Web-it te institucioni. Gjithashtu KU Beder ne zbatim të përcaktimeve rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" ka informuar studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe</p>

	<i>diplomimit në programin e studimit. Studentet mund të zgjedhin një provim formues ose një punim diplome.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion dhe dokumentacionin e nevojshëm për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" si dhe për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtarisë formuese. Në javën e parë të orientimit, në zbatim të rregullores së programit të studimit, krahas prezantimit të programit të studimit, me të gjithë elementët nga dekani dhe përgjegjësi i departamentit, realizohet prezantimi i objektivave dhe njohurite dhe aftësitë e fituara nga secila lëndë. Në javën e parë të mësimin në secilën lëndë bëhet prezantimi i detajuar i lëndës, përmbajtja dhe veprimtaritë e parashikuara formuese.</p> <p><i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë;</i> <i>DVV Evidenca: https://www.beder.edu.al/sh/content/default/departamenti-i-shkencave-kompjuterike-10-6/657/590.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Në javën e parë të mësimin në secilën lëndë bëhet prezantimi i detajuar i lëndës, përmbajtja dhe veprimtaritë e parashikuara formuese. Ky informacion u bëhet i ditur studentëve edhe në faqen zyrtare të informacionit, broshurave informuese dhe syllabuset e lëndëve, të cilat ngarkohen nga secili pedagog. Gjithashtu studentet njihen dhe me sistemin BIS ku informohen dhe për të dhenat e tjera.</p> <p><i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë;</i> <i>DVV Evidenca: https://www.beder.edu.al/sh/content/default/departamenti-i-shkencave-kompjuterike-10-6/657/590;</i> <i>DVV Evidenca 30: Shembull Orari mesimor (tt.beder.edu.al).</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga KU Beder dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në institucion, GVJ konstaton se Zyra e Karrieres e cila funksionon pranë dekanatit të studenteve është</p>

<p>institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>struktura mbështetese që informon studentët mbi mundësitë e punësimit, këshillon, mbështet dhe orienton studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" për tregun e punës. Studentët janë udhëzuar dhe kanë përfituar nga marrëveshjet me institucione private dhe shtetërore për praktika mësimore dhe janë ftuar dhe në aktivitetet e përbashkëta të realizuara si në rastin e bashkëpunimit për praktikat mësimore dhe studimore dhe aktivitetet e tjera institucionet bashkëpunuese. Përgjithësisht studentët e këtij programi studimi janë të punësuar. Në mënyrë të veçantë për ata studentë të këtij programi studimi që nuk janë të punësuar janë informuar në mënyrë të vazhdueshme për mundësi të ndryshme punësimi.</p> <p><i>DVV Evidenca 18: Vendimi i Keshillit të Departamentit për perfaqësuesin në zyrën e karrierës;</i> <i>DVV Evidenca 19: Vendimi i Keshillit të Departamentit për keshilltarin akademik;</i> <i>DVV Evidenca 3: Kompanite ku janë punësuar studentet e masterit të Shkenca Kompjuterike.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Ne baze të dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se institucioni informon studentët nëpërmjet burimeve të ndryshme mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën mbështetëse, si dhe shërbimet e ofruara nga institucioni në funksion të realizimit të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Që në javën e parë të orientimit studentët njihen me kalendarin akademik, orarin mësimor, ambientet, mjetet dhe shërbimet në funksion të programit të studimit. Gjithashtu në vazhdim të studimeve çdo grup i caktuar studentesh është nën kujdesjen e një keshilltari akademik i cili i ndihmon në vazhdim me problematika të ndryshme.</p> <p><i>DVV Evidenca 19: Vendimi i Keshillit të Departamentit për keshilltarin akademik;</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacionet për programin e studimit u mundësohen studentëve nëpërmjet sistemit BIS. Njoftime shfaqen në sistemin BIS direkte nga sekretariate të njesive perkatese. Sekretaria njoftimit zyrtare I ben në adresat elektronike të KU Beder që kanë studentet sapo futen te studiojne në këtë institucion. Në lidhje me njoftimet për studentet e regjistruar ose atë rinjte ato behen në faqen zyrtare të informacionit.</p> <p><i>DVV Evidenca 43: Udhëzues i Sistemit Informativ Beder (BIS);</i> <i>DVV Evidenca 45: Guida e Studentit.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion dhe dokumentacionin e nevojshëm për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, Master i Shkencave</i></p>

	në "Shkenca Kompjuterike" si dhe për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtarisë formuese. Në javën e parë të orientimit, në zbatim të rregullores së programit të studimit, krahas prezantimit të programit të studimit, me të gjithë elementët nga dekani dhe përgjegjësi i departamentit, realizohet prezantimi i objektivave dhe njohurite dhe aftësitë e fituara nga secila lëndë. Informacionet për programin e studimit u mundësohen studenteve nepermjet sistemit BIS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet
				X

Standardi V.4									
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.									
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se në sekretarinë mësimore të institucionit mbahen dhe regjistrohen të dhëna vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. Në këtë programi studimi të dhënat e studentëve të regjistruar dhe diplomuar janë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Sipas vitit akademik</th> <th>Studente te regjistruar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2021-2022</td> <td>12</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>19</td> </tr> </tbody> </table> <p>Perpunimi i te dhenave te studenteve behet nga sekretaria mesimore, qe mban dhe statistika per te diplomuarit.</p> <p><i>DVV Evidenca 50: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore.</i> <i>DVV Evidenca 44: Performanca e studentëve nga Zyra e Sekretarisë Mësimore.pdf</i></p>	Sipas vitit akademik	Studente te regjistruar	2021-2022	12	2022-2023	7	Total	19
Sipas vitit akademik	Studente te regjistruar								
2021-2022	12								
2022-2023	7								
Total	19								
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se siç u cilësua dhe në kriterin e parë, institucioni disponon të dhëna vjetore për studentët e regjistruar, transferuar dhe diplomuar. Nga IAL disponohen dhe statistika për tërheqjet apo largimet nga programi i studimit para përfundimit të studimeve. Keto statistika mbahen në sekretarinë mësimore dhe institucioni siguron informacion në kohë reale në sistemin BIS dhe nepermjet sekretarive të njesive kryesore.</p>								

vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	DVV Evidenca 50: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit dhe dokumentacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, u konstatua se siç është cilësuar edhe më lart në raport, për menaxhimin e informacionit të brendshëm sekretaria mësimore përdor për të dhënat statistikore të studentëve, si dhe akseson dhe realizon verifikimin e tyre. Institucioni ka në Sistemin BIS për menaxhimin e plote informacionit në institucion. DVV Evidenca 63: Procedura për auditimin periodik të brendshëm; DVV Evidenca 50: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni KU Beder bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion dhe gjatë vizitës së GVJ ka paraqitur që ben kontrolle periodike të njësive përgjegjëse për menaxhimin e njësive të veta si sekretaria mësimore dhe të sistemit të brendshëm të informacionit. Në dokumentacion ka paraqitur procedurat për auditimin periodik. DVV Evidenca 63: Procedura për auditimin periodik të brendshëm; DVV Evidenca 50: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore.
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit dhe dokumentacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, u konstatua se institucioni ka paraqitur raporte analitike , periodike për periudha të ndryshme vjetore për cilësinë e hyrje daljeve të studenteve. Gjithashtu për tju ardhur në ndihmë studenteve ata kanë krijuar lidhje dhe marrveshje me kompani që të kenë mundësinë e kontaktit direkte me tregun e punës. Një njesi e vecante e krijuar është dhe ajo e keshilltarit akademik i cili mban kontaktin direkte me studentet dhe i orienton ata dhe në tregun e punës. Atij i hapet një akses i vecante në llogarinë në BIS për komunikimet direkte me studentet që ka në përgjegjësi. DVV Evidenca 51: Raporti vjetor institucional, për vitin akademik 2017-2018; DVV Evidenca 18: Raporti Institucional 2019-2020 KOLEGJI UNIVERSITAR "BEDËR"; DVV Evidenca 19: Raporti institucional 2020-2021; DVV Evidenca 20: Raporti institucional 2021-2022; DVV Evidenca 25: Rregullorja mbi organizimin akademik.
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se në sekretarinë mësimore të institucionit mbahen dhe regjistrohen të dhëna

	<p>vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. Institucioni KU Beder ka paraqitur qe ben kontrrolle periodike te njesive pergjegjese per menaxhimin e njesive te veta si sekretaria mesimore dhe te sistemit e brendshem te menaxhimit te informacionit. Institucioni ka paraqitur raporte analitike , periodike per periudha te ndryshme vjetore per cilesine e hyrje daljeve te studenteve. Gjithashtu per tju ardhur ne ndihme studenteve ata kane krijuar lidhje dhe marrveshje me kompani qe te kene mundesine e kontaktit direkte me tregun e punes.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se institucioni ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit, përkatësisht në statusin dhe rregulloren e institucionit, ku specifikohet qartë parashikimi i përfshirjes dhe angazhimit, si dhe roli i Këshillit studentor për përfshirjen dhe angazhimin të përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese. Dekani i studenteve është një tjetër strukturë që ben te mundur bashkepunimin direkte me Rektorin dhe Zv. Rektorin.</p> <p><i>DVV Evidenca 52: Vendim i Senatit Akademik për studentët përfaqësues në mbledhje;</i> <i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se institucioni ka garantuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit, përkatësisht në statusin dhe rregulloren e institucionit, përkatësisht në senatin akademik, komisionet e përhershme dhe në NjBSC. Institucioni zhvillon anketime periodike per vleresimin e personelit ne fund te cdo simestri dhe viti akademik.</p> <p><i>DVV Evidenca 31: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve;</i></p>

	<p><i>DVV Evidenca 53: Formular ankete e studentit për lëndën dhe pedagogun;</i> <i>DVV Evidenca 52: Vendim i Senatit Akademik për studentët përfaqësues në mbledhje;</i> <i>DVV Evidenca 60: Anketa e studentit ndaj lëndës.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se bazuar në statutin e institucionit, studentët janë të përfshirë në të gjitha organet kolegjiale vendimmarrëse. Përtej përfaqësuesve të studentëve në organet e mësipërme, institucioni garanton mbledhjen e mendimeve, opinionëve dhe sugjerimeve të studentëve me anketimet periodike në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Në këtë program studimi, Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" nuk është realizuar asnjë proces rishikimi apo përmirësimi i këtij programi studimi.</p> <p><i>DVV Evidenca 60: Anketa e studentit ndaj lëndës;</i> <i>DVV Evidenca 62: Formulari i "Anketës me të diplomuarit për programin e studimit".</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësish/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se institucioni u mundëson studentëve së pari vënien në dispozicion dhe informimin mbi kriteret dhe procesin e vlerësimit të dijeve në programin e studimit, Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", në javën e informimit dhe gjatë javës së parë të mësimit për çdo lëndë. Studentëve ju mundësohet nëpërmjet procedurave të rregulluara e drejta e barazisë dhe transparencës në vlerësimin dhe kontrollin e dijeve, si dhe mundësisë së ankimit të rezultatit, kërkesës për rishikim të tij. Studentët e këtij programi studimi, e pohuan edhe në takimin me përfaqësues të studentëve gjatë vizitës në institucion që janë të informuar me procedura dhe rregullat që mund të ndjekin nëse dëshirojnë të ankimojnë një vlerësim. Në përfundim të çdo semestri, studentët nëpërmjet anketimeve japin opinionin e tyre për të gjitha aspektet e jetës studentore brenda institucionit.</p> <p><i>DVV Evidenca 54: Anketë vlerësimi e studentëve ndaj institucionit;</i> <i>DVV Evidenca 14: Rregullorja e studimeve dhe provimeve te ciklit te dyte.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se bazuar në statutin e institucionit, studentët janë të përfshirë në të gjitha organet kolegjiale vendimmarrëse. Përtej përfaqësuesve të studentëve në organet e mësipërme, institucioni garanton mbledhjen e mendimeve, opinionëve dhe sugjerimeve të studentëve me anketimet periodike në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Studentët e këtij programi studimi, e pohuan edhe në takimin me përfaqësues të studentëve</i></p>

	<i>gjatë vizitës në institucion që janë të informuar me procedura dhe rregullat që mund të ndjekin nëse dëshirojnë të ankimojnë një vlerësim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përbërshme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se institucioni ka ngritur njesi te vetat si zyra e Karrieres, Dekani studenteve dhe Keshilltari akademik te cilet informojne studentët mbi mundësitë e punësimit, këshillojne, mbështetin dhe orientojne studentët, përfshire dhe programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Informacionet e nevojshme per programin master publikohen dhe ne faqen e Web-it te institucionit. Silabuset e lendeve merren nga lektoret ne fillim te cdo viti akademik. Gjithashtu si organe informacioni eshte edhe sekretaria mesimore ose sekretaria e departamentit. <i>DVV Evidenca 16: videnca nr. 16 Organigrama e Fakultetit;</i> <i>DVV Evidenca 25: Rregullorja mbi organizimin akademik.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstatoi se institucioni ka ngritur njesi te vetat si zyra e Karrieres, Dekani studenteve dhe Keshilltari akademik te cilet informojne studentët mbi mundësitë e punësimit, këshillojne, mbështetin dhe orientojne studentët, përfshire dhe programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Pra insitucioni ka ngritur nje sistem te posacem per informimin, keshillimin dhe ndjekjen e perparimit te studenteve ne kete program studimi. Keshilltari akademik qe eshte nje nga njesite caktohet me vendim departamenti. Ai perfshihet pothuajse ne te gjithë ecurine akademike te studenteve nga fillimi deri ne fund te studimeve te tyre. <i>DVV Evidenca 19: Vendimi i Keshillit te Departamentit per keshilltarin akademik;</i> <i>DVV Evidenca 18: Vendimi i Keshillit te Departamentit per perfaqesuesin ne zyren e karrieres.</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të	KU Beder per sherbimin e keshillimit te karrieres se studenteve ka te ndritur nje njesi qe eshte zyra e karrieres e cila funksionon prane dekanatit te studenteve. Ne zyren e karrieres emerohet nje keshilltar nga cdo depratament per te orientuar studentet. Keto u konstantuan dhe gjate vizite se GVJ dhe takimit me zyren e karrieres.

<p>posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p><i>DVV Evidenca 19: Vendimi i Keshillit të Departamentit për keshilltarin akademik;</i> <i>DVV Evidenca 18: Vendimi i Keshillit të Departamentit për perfaqësuesin në zyrën e karrieres.</i></p>		
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se Zyra e Karrieres, si pjesë e detyrave të përcaktuara në rregulloren e kësaj zyre ndjek dhe mbështet studentët e diplomuar në programin e studimit, duke grumbulluar, përpunuar dhe regjistruar të dhënat mbi punësimin dhe cilësinë e punësimit të tyre në raport me programin e studimeve.</p> <p>Ku Beder ka ngritur në strukturën e vet dhe zyrën e të diplomuarve që është në varesi të dekanit të studenteve. Për programin Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike këtë vit është brezi i parë i të diplomuarve. Një pjesë e studenteve të këtij programi studimi janë të punësuar dhe është paraqitur dhe një listë me kompanitë në të cilat janë duke punuar aktualisht.</p> <p><i>DVV Evidenca 3: Kompanitë ku janë punësuar studentet e masterit të Shkencave Kompjuterike;</i> <i>DVV Evidenca 18: Vendimi i Keshillit të Departamentit për perfaqësuesin në zyrën e karrieres.</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se institucioni ka ngritur njësi të vetat si zyra e Karrieres, Dekani i studenteve dhe Keshilltari akademik të cilët informojnë studentët mbi mundësitë e punësimit, këshillojnë, mbështetin dhe orientojnë studentët, përfshirë dhe programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike".</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------	-----------------------------	--

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU "Bedër", GVJ konstaton se janë hartuar udhëues të ndryshëm për mesimdhënien në auditor inovative, mesimdhënien në distancë, për Sistemin informative BIS, etj.</p> <p>Institucioni KU "Bedër" për programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike në të cilët duhet të bazohet me shumë në mesimdhënie inovative dhe të integruar me praktiken ka përfshirë dhe politika për udhëzime për kontrollin e zbatimit të saj.</p> <p><i>DVV Evidenca 69: Udhëzim mbi mesimdhënien inovative.pdf</i> <i>DVV Evidenca 29: Udhëzim mbi mesimdhënien në distancë.pdf</i> <i>DVV Evidenca 43: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS).pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mesimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmesakademik.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga GVB dhe nga vizita në ambientet e KU "Bedër", GVJ konstaton se në institucion strukturat përgjegjëse për mekanizmat e monitorimit bëjnë të mundur vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive të mesimdhënies inovative nga stafi akademik dhe ndihmesakademik. KU "Bedër" çdo semestër organizon anketa me studentët për vlerësimin e stafit dhe të lëndës. Stafi plotëson gjithashtu një formular vetëvlerësimi në fund të të cilit bëhet dhe vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit për çdo lektor. Bëhet dhe një anketë për vlerësimin e stafit akademik administrative ndaj institucionit.</p> <p><i>DVV Evidenca 60: Anketa e studentit ndaj lëndës;</i> <i>DVV Evidenca 61: Anketë vlerësimi e stafit akademik administrativ ndaj institucionit;</i> <i>DVV Evidenca 32: Vendim i Komisionit të vlerësimit;</i> <i>DVV Evidenca 70: Formular i vlerësimit për stafin akademik;</i> <i>DVV Evidenca 71: Raport përmbledhje vlerësimi për stafin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që GVB ka vendosur në dispozicion dhe vizitës në ambientet e KU "Bedër" konstatohet se institucioni I ka përfshirë studentët në vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe dijeve Studentët janë përfshirë në njësitë kryesore për vlerësimin e cilësisë dhe si pjesë e NJSBC.</p> <p>Studentët vlerësojnë anketat e vlerësimit për pedagogun e lëndës dhe anketat e vlerësimit për institucionin të cilat janë të paraqitura dhe në dokumentacion.</p> <p>Studentet kanë gjithashtu mundësinë e ankimimit të vlerësimit që marrin duke plotësuar formularin e ankimimit që është paraqitur dhe në dokumentacion.</p> <p><i>DVV Evidenca 60: Anketa e studentit ndaj lëndës;</i> <i>DVV Evidenca 55: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së;</i> <i>DVV Evidenca 54: Anketë vlerësimi e studentëve ndaj institucionit;</i> <i>DVV Evidenca 39: Formular ankimimi;</i></p>

<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p><i>DVV Evidenca 38: "Anketa me studentë për programin e studimit".</i></p> <p>Insitucioni si njësi përgjegjëse për monitorimin e mësimdhënies dhe cilësisë së saj ka NJSBC. Ajo merr dhe përpunon rrezultatet e monitorimit dhe ia përcjell rektoratit. Rezultatet e vlerësimit të pedagogut dhe të lëndës nga rektorati i kalojnë përgjegjësive të departamenteve përkatëse. Rezultatet e anketave të institucionit bëhen publike në faqen e Web-it. Në bazë të raporteve të vetëvlerësimit, vlerësimi i njësisë i përcillet dekanatit dhe me pas rektoratit.</p> <p><i>DVV Evidenca 60: Anketa e studentit ndaj lëndës;</i> <i>DVV Evidenca 55: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së;</i> <i>DVV Evidenca 54: Anketë vlerësimi e studentëve ndaj institucionit;</i> <i>DVV Evidenca 70: Formular i vlerësimit per stafin akademik;</i> <i>DVV Evidenca 71: Raport permbledhje vleresimi per stafin akademik.</i></p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>KU "Bedër" në bazë të vlerësimit të vetë bazuar në rezultatet e marra ka shpallur listën e stafit me performacë më të lartë për të dy fakultetet e tij. Vlerësimi i stafit akademik dhe i praktikave të mira bëhet nga eprorët në raportet vjetore të njësisë dhe në takimet ose mbledhjet me personelin akademik.</p> <p><i>DVV Evidenca 70: Formular i vlerësimit per stafin akademik;</i> <i>DVV Evidenca 71: Raport permbledhje vleresimi per stafin akademik.</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se janë hartuar dhe zbaton politika, struktura dhe procedura, në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe ato rregullatore të institucionit. KU "Bedër" ka hartuar udhëzues të ndryshëm për mësimdhënien në auditor inovative, mesimdhënien në distance, për Sistemin informative BIS, etj. të cilët janë paraqitur dhe në dokumentacionin e dorëzuar nga GVB. Rezultatet e vlerësimit të pedagogut dhe të lëndës nga rektorati i kalojnë përgjegjësive të departamenteve përkatëse. Rezultatet e anketave të institucionit bëhen publike në faqen e Web-it. Në bazë të raporteve të vetëvlerësimit, vlerësimi i njësisë i përcillet dekanatit dhe me pas rektoratit. Vlerësimi i stafit akademik dhe i praktikave të mira bëhet nga eprorët në raportet vjetore të njësisë dhe në takimet ose mbledhjet me personelin akademik.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="580 1615 794 1733"></th> <th data-bbox="794 1615 991 1733"></th> <th data-bbox="991 1615 1193 1733">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1193 1615 1396 1733">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se janë hartuar dhe zbaton politika, struktura dhe procedura, në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe ato rregullatore të institucionit. Misioni i arsimit të lartë është të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet europiane. Një nga funksionet e Senatit akademik është të ngrejë njësinë e brendshme të sigurimit të cilësisë përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. KU "Beder" ka ngritur njësinë e brendshme të sigurimit të cilësisë dhe dy komisione të përhershme të cilët kanë dhe faqen zyrtare në Web. Funksionimi i tyre është dhënë dhe në rregulloren e "Beder". NJSBC është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe për verifikimin periodik të saj janë përgjegjëse komisionet e përhershme.</p> <p><i>DVV Evidenca 10: Statusi i KUB;</i> <i>DVV Evidenca 56: Vendim senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme;</i> <i>DVV Evidenca: www.qac.beder.edu.al;</i> <i>DVV Evidenca 55: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU "Beder", GVJ konstaton se Institucioni ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si një strukturë e përhershme e cila është funksionale. Njësia funksionale e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në KU "Beder" zbaton strategjinë e miratuar të institucionit që ka në fokus kryesor përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, duke përfshirë në këtë proces ekspertë të jashtëm, si dhe përfaqësues të studentëve. Ajo zbaton mekanizma të monitorimit në mënyrë periodike të kontrollit të afësive mesimdhënëse innovative të stafit akademik dhe ndihmës akademik. Për verifikimin periodik dhe cilësinë e përmirësimit të saj janë krijuar komisionet e përhershme. NJSBC përbëhet nga 5 anëtare, 3 pedagogje të brendshëm, një student dhe një ekspert i jashtëm.</p> <p><i>DVV Evidenca 55: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së.</i> <i>DVV Evidenca 55: Vendim senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme.</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU "Bedër", GVJ konstaton se Njësia funksionale e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në institucion ka hartuar dhe manualin e e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, bazuar në përcaktimet ligjore në fuqi për kodin e cilësisë i cili përmban dhe përshkruan të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me mënyrën e vetëvlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe aspekte të menaxhimit të cilësisë. NJSBC në funksion të detyrës për garantimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë bazuar në aktet rregullatore të Bedër, ka përdorur instrumentat e duhura në zbatim të strategjisë dhe manualit të miratuar të NJSBC kryesisht nëpërmjet procedurave të verifikimit, dokumentimit, anketimit dhe takimeve të zhvilluara me palët e interesuara. "Bedër" ka kaluar me sukses tre akreditime institucionale, të parin në 2013 nga APAAL, të dytin në 2017 nga Agjensia Britanike e Akreditimit në bashkëpunim me ASCAL dhe të tretin në 2021. "Bedër" mbështet sigurimin e cilësisë duke përdorur procesin e anketimit dhe të vlerësimit.</p> <p><i>DVV Evidenca 12: Planit strategjik Institucional;</i> <i>DVV Evidenca 31: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve;</i> <i>DVV Evidenca 55: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU "Bedër", GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një politikë të qartë për të ndjekur në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë procedura periodike që garantojnë dhe përmirësojnë cilësinë e programeve të studimeve, në këtë rast Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". NJSBC ka përdorur instrumentat e duhura në zbatim të strategjisë dhe rregulloren e miratuar të NJSBC, sipas një plani kalendarik, kryesisht nëpërmjet procedurave të verifikimit, dokumentimit, anketimit dhe takimeve të zhvilluara me palët e interesuara. Bedër I ka kushtuar rendesi te vecante proceseve te dnyrshme vetevleresuese administrative dhe insitucionale. NJSBC organizon 2 herë në vit, në mënyrë anonime, 2 javë para përfundimit të aktivitetit mësimor semestral, pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies në çdo program studimi, përfshirë edhe programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Këto janë të paraqitura dhe në statutin e institucionit.</p> <p>Në përmbushje të cilësisë së mësimdhënies, KU "Bedër" ka paraqitur një plan strategjik 5 vjeçar të institucionit 2018-2023 i cili vë në fokus të veçantë elementet e vlerësimit dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kontributit në shoqëri.</p> <p><i>DVV Evidenca 12: Planit strategjik Institucional;</i> <i>DVV Evidenca 57: Plan veprimi për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor;</i></p>

	<i>DVV Evidenca 10: Statusi i KUB;</i> <i>DVV Evidenca 55: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së;</i> <i>DVV Evidenca 22: Raporti vjetor i Departamentit.</i>			
Konkluzione	<i>KU "Bedër" ka ngritur njësinë e brendshme të sigurimit të cilësisë dhe dy komisione të përhershme të cilët kanë dhe faqën zyrtare në Web. Funksionimi i tyre është dhënë dhe në rregulloren e "Bedër", NJSBC është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe për verifikimin periodik të saj janë përgjegjëse komisionet e përhershme. NJSBC organizon dy herë në vit, në mënyrë anonime, 2 javë para përfundimit të aktivitetit mësimor semestral, pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies në çdo program studimi, përfshirë edhe programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Keto jane te paraqitura dhe ne statutin e insitucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.3	Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.		
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga GVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstantoi që KU "Bedër" përdor procese formale dhe të dokumentuara për mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike. Gjatë këtyre proceseve evidentohen arritjet dhe dobësitë dhe nëse është e nevojshme për ndryshim kurrikule me pas ato i kalojnë senatit, që monitoron veprimtarinë e komisioneve të përhershme. Më pas ato i kalojnë njësisë bazë, njësisë kryesore dhe në rektorat.</p> <p>Senati për përmirësimin e cilësisë ka miratuar: Politikat e KU "Bedër" për përmirësimin e programeve të studimit, formulari i anketës me të diplomuarit e programit të studimit dhe formulari i anketës me studentët për programin e studimit.</p> <p><i>DVV Evidenca 63: Procedura për auditimin periodik te brendshëm;</i> <i>DVV Evidenca 58: Politikat e KU beder per permiresimin e programeve te studimit.</i> <i>DVV Evidenca 62: Formulari i "Anketës me të diplomuarit për programin e studimit";</i> <i>DVV Evidenca 38: "Anketa me studentë për programin e studimit".</i></p>		
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit,	KU "Bedër" ka paraqitur në dokumentacion që raportet e vlerësimit të anketës së studentëve u përcillen lektoreve në zarfa e mbyllur. Gjithashtu		

<p>motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>rezultatet e vetëvlerësimit të stafit akademik dhe vlerësimit të tyre nga përgjegjësi i departamentit i përcillen përgjegjësit të njësisë kryesore. Institucioni ka nxjerr renditjen e punonjesve me arritjet më të mira, kurse studentët më të mire janë bërë prezantime përpara stafit. Raportet e akreditimit dhe të auditimit të brendshëm shoqërohen me plane veprimi, ku parashikohen rezultatet e vlerësimit, masat që do të ndërmerren dhe përmirësimi në vijim të cilësisë dhe rezultatit të prishëm.</p> <p><i>DVV Evidenca 63: Procedura për auditimin periodik te brendshëm;</i> <i>DVV Evidenca 58: Politikat e KU beder per perrmiresimin e programeve te studimit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>KU "Bedër" në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes së programit të studimit përdor metoda të drejtëpërdrejta si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësimi i didaktikës, kurrikulës etj. Cilësia e mësimdhënies vlerësohet me metoda të ndryshme të anketimit kryesisht nëpërmjet anketës së pedagogut dhe lëndës. Gjithashtu vlerësimi i cilësisë arrihet dhe nga takimet e ndryshme me profesionistë të fushës në treg. Një pjesë e pedagogëve që japin mësim tek ky program janë të integruar dhe në tregun e punës në fushën e teknologjisë dhe kjo është një ndihme për praktika sa me efektive me studentët e këtij programi. Gjithashtu në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional bëhet e mundur që të aplikohen dhe metoda të drejtpërdrejta si seancat brainstorming. Në dokumentacion janë paraqitur dhe trajnime e bëra.</p> <p><i>DVV Evidenca shtese 23: Trajnimet me prof Hung;</i> <i>DVV Evidenca 60: Anketa e studentit ndaj lëndës;</i> <i>DVV Evidenca 61: Anketë vlerësimi e stafit akademik administrativ ndaj institucionit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion, KU "Bedër" përdor metoda dhe instrumente të tërthorta vlerësimi për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. Ndër këto metoda është ajo e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës duke u nisur nga anketat që i bëhen studenteve në fund të çdo simestri studimi. Në dokumentacion janë paraqitur modelet e anketimeve të përdorura. Gjatë vizitës në institucion u panë dhe raportet e nxjerra nga NJSBC për vlerësimet e marra. Kurse metodat e drejtpërdrejta janë ato të përfshira me vlerësime direkte në syllabus-et e lëndëve.</p> <p><i>DVV Evidenca 60: Anketa e studentit ndaj lëndës;</i> <i>DVV Evidenca 61: Anketë vlerësimi e stafit akademik administrativ ndaj institucionit.</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ konstantoi që KU "Bedër" përdor procese formale dhe të dokumentuara për mbikqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike. Gjatë këtyre proceseve evidentohen arritjet dhe dobësitë dhe nëse është e nevojshme për ndryshim kurrikule, pastaj ato i kalojnë senatit, që monitoron veprimtarinë e komisioneve të përhershme. Më pas ato i kalojnë njësisë bazë, njësisë kryesore dhe në rektorat. Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion, KU "Bedër" përdor metoda dhe instrumente të tërthorta vlerësimi për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. Ndër këto metoda është ajo e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës duke u nisur nga anketat. Kurse metodat e drejtpërdrejta janë ato të përfshira me vlerësime direkte në syllabus-et e lëndeve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU "Bedër", GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe garanton që në zbatimin e politikave dhe procedurave të brendshme të cilësisë të përfshihen aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Senati është organi kolegjal që vlerëson dhe garanton cilësinë e programeve të studimit në të cilin janë pjesë të gjitha njësitë drejtuese. Senati ngre komisionet e përhershme për garantimin e standarteve të cilësisë dhe miraton zgjedhjen e anëtarëve të NJSBC. Këto janë dy organet përzgjedhëse për garantimin e cilësisë në KU "Bedër". <i>DVV Evidenca 55: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se IAL, ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për NJSBC, njësitë, studentët dhe palët e tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" duke garantuar përgjegjshmëri në ushtrimin e detyrave. Në rregulloren institucionale janë përcaktuar përgjegjësitë e dy strukturave të sigurimit të cilësisë, NJSBC dhe komisioni përhershëm. NJSBC ka autonomi operative dhe akses në institucion kurse Komisioni përhershëm

	<p>është organ kolegjal. Ky komision i perhershëm përveç hartimit të politikave dhe të standarteve të cilësisë monitoron dhe kryen vlerësime periodike të programeve.</p> <p><i>DVV Evidenca 55: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së</i></p> <p><i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Në nivel institucioni përgjegjës të këtij procesi të rëndësishëm janë senati akademik, rektori, NJBSC, komisionet e përhershme, grupet e vlerësimit të brendshëm, dekani si dhe GVB dhe studentët. Detyrat e tyre janë të mirëpërcaktuara në planin e aktiviteteve të strategjisë së NJBSC me objektiv madhor sigurimin e cilësisë të procesit mësimor në programin e studimit, Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" si dhe kërkohet pjesëmarrja aktive në propozimin, përcaktimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të modeleve vlerësuese sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit. Në analizat vjetore dhe trajnuese marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe administrative.</p> <p><i>DVV Evidenca 55: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së;</i></p> <p><i>DVV Evidenca 30: Lista e trajnimeve të stafit, viti akademik 2020-2022.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se Institucioni ka përfshirë dhe aktivizuar personel akademik të brendshëm dhe të jashtëm me eksperiencë si pjesë e NJBSC dhe e GVB të fakulteteve, si dhe përfaqësues të këshillit studentor të përzgjedhur në një proces të bazuar në vlerat më të mira dhe tërësisht transparent. Këta aktorë të brendshëm janë pjesëtar aktivë të procesit të vlerësimit të brendshëm në nivel institucioni dhe programi studimi. Senati akademik si strukturë përgjegjëse ka për detyrë të garanojë respektimin e integritetit të të gjithë aktoreve të përfshira në vlerësimin e cilësisë.</p> <p><i>DVV Evidenca 55: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së;</i></p> <p><i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore.</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU Beder, GVJ konstaton se Institucioni ka përfshirë dhe aktivizuar personel akademik të brendshëm dhe të jashtëm me eksperiencë si pjesë e NJBSC dhe e GVB të fakulteteve, si dhe përfaqësues të këshillit studentor të përzgjedhur në një proces të bazuar në vlerat më të mira dhe tërësisht transparent.</p> <p>Ndërkohë përfshirja e ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit është vetëm në nivel institucioni dhe jo në nivel programi studimi.</p>

	Organizohen dhe takime konsultative me ekspertë të fushës për tu informuar më tepër mbi zhvillimet në tregun e punës. <i>DVV Evidenca 63: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së;</i> <i>DVV Evidenca 23: Rregullorja Themelore.</i>						
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe garanton që në zbatimin e politikave dhe procedurave të brendshme të cilësisë të përfshihen aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Senati është organi kolegjal që vlerëson dhe garanton cilësinë e programeve të studimit në të cilin janë pjesë të gjitha njësitë drejtuese. Senati ngre komisionet e përherëshme për garantimin e standarteve të cilësisë dhe miraton zgjedhjen e anëtareve të NJSBC.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton se KU "Bedër", ka hartuar dhe zbaton politika dhe strategji transparente për organizimin dhe aktivitetet në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë, përfshirë edhe programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Ato janë transparente dhe janë të aksesueshme për të gjithë të interesuarit dhe studentet në faqen e sigurimit të cilësisë në Web (https://qac.beder.edu.al). Studentët njihen me aktivitetet të cilat u dergohen dhe me email dhe informacioni për përfshirjen e tyre në vlerësimin e cilësisë jepet dhe në guidën e studentit. <i>DVV Evidenca 45: Guida e Studentit.</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga GVB dhe nga vizita në institucion KU "Bedër", u konstatua që institucioni i publikon rezultatet e vlerësimeve të brendshme të programeve. Ato i vihen në dispozicion personelit akademik. Kurse raportet e akreditimeve të programeve apo vlerësime të jashtme publikohen dhe për studentët në faqen e Web-it të sigurimit të cilësisë. <i>DVV Evidenca: https://qac.beder.edu.al;</i> <i>DVV Evidenca 2: Vendimi i akreditimit Institucional 2013;</i> <i>DVV Evidenca 3: Vendimi i akreditimit Institucional 2017.</i>

77

<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstaton se KU "Bedër", në raportet e përgatitura pas nxjerrjes së rezultateve të vlerësimit, ka evidentuar një plan masash që duhet të ndërmerren nga grupet dhe aktorët e përfshirë dhe interesuar për të arritur objektivin e përmirësimit të mangësive të identifikuar. Rezultatet e marra nga procesi i vlerësimit periodik janë përdorur jo vetëm për vlerësimin e procesit dhe identifikimin e problematikave, por edhe me objektiv marrjen e masave për përmirësimin e garantimin e cilësisë së brendshme të programeve të studimit.</p> <p>Disa nga masat e marra në drejtim të përmirësimit të cilësisë janë: trajnimet e vazhdueshme mbi metodat e suksesshme didaktike në mësimdhënie dhe kërkim shkencor; mbështetja e stafit akademik për pjesëmarrjen dhe përfshirjen në aktivitete dhe projekte zhvilluese edhe jashtë institucionit.</p> <p><i>DVV Evidenca 63: Procedura për auditimin periodik te brendshëm;</i> <i>DVV Evidenca 57: Plan veprimi për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor;</i> <i>DVV Evidenca 58: Politikat e KU beder per permiresimin e programeve te studimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se KU Bedër, ka vlerësuar dhe siguron monitorim të vazhdueshëm të procesit të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit, Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Ky proces vlerësimi dhe monitorimi ka objektiv madhor sigurimin e efektivitetit dhe impaktit të masave të marra për përmirësimin e mangësive dhe problematikave të identifikuar gjatë procesit të vlerësimeve periodike dhe siguron përmirësimin e cilësisë dhe të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Informacionet e marra nga pyetësorë të ndryshëm janë pjesë e raportimeve të ndryshme periodike që bëjnë njësitë kryesore respektive.</p> <p><i>DVV Evidenca 63: Procedura për auditimin periodik te brendshëm;</i> <i>DVV Evidenca 58: Politikat e KU beder per permiresimin e programeve te studimit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se KU "Bedër", ka përfshirë stafin akademik dhe studentët në proceset e informimit, ndërgjegjësimin së tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë e cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet: pjesëmarrjes së tyre në NJBSC; pjesëmarrjes në GVB ad-hoc të programeve të studimit në proces akreditimi; në javën e orientimit në fillim të vitit akademik; dhe në mënyrë të tërthortë dhe me procesin e pyetësorëve të studentëve.</p> <p><i>DVV Evidenca 59: Guida e Stafit;</i> <i>DVV Evidenca 58: Politikat e KU beder per permiresimin e programeve te studimit.</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KU "Bedër", ka hartuar dhe zbaton politika dhe strategji transparente për organizimin dhe aktivitetet në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë, përfshirë edhe programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike". Ato janë transparente dhe janë të aksesueshme për të gjithë të interesuarit dhe studentet në faqen e sigurimit të cilësisë në Web (https://qac.beder.edu.al). GVJ konstaton se KU Beder, në raportet e përgatitura pas nxjerrjes së rezultateve të vlerësimit, ka evidentuar një plan masash që duhet të ndërmerren nga grupet dhe aktorët e përfshirë dhe interesuar për të arritur objektivin e përmirësimit të mangësive të identifikuara. Rezultatet e marra nga procesi i vlerësimit periodik janë përdorur jo vetëm për vlerësimin e procesit dhe identifikimin e problematikave, por edhe me objektiv marrjen e masave për përmirësimin e garantimin e cilësisë së brendshme të programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	--	------------------------------	-----------------------------	-----------------------------------

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" të institucionit të arsimit të lartë Kolegji Universitar "Beder"

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike moderne në dispozicion të programit të studimit ofron hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor.
2. Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Kolegji Universitar Beder dhe të zhvillimit ekonomik të vendit dhe plotëson nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.
3. Staf akademik me përvojë në fushën e mësimdhënies dhe industri.
4. Institucioni ka zhvilluar mekanizma specifike për mbështetjen dhe kualifikimin profesional të personelit akademik.
5. Sistemi funksional elektronik të menaxhimit të informacionit në funksion të administrimit të brendshëm të institucionit, por dhe të gjithë aktivitetit didaktik.
6. Kujdesi ndaj studentit realizohet në plotësim të të gjitha kushteve kontraktuale.
7. Proces selektiv përzgjedhës për studentët në hyrje bazuar në meritë dhe vlerësimi i meritave me bursa akademike e cila rrit cilësinë e studentëve në hyrje.
8. Punësim i lartë si studentëve që ndjekin programin e studimit.

Pika të dobta:

1. Në disa lëndë vërehet angazhimi në procesin mësimor i personelit akademik të kategorisë "Asistent Lektor".
2. Literatura e detyrueshme e programit të studimit, në disa lëndë është jo e 5 viteve të fundit, si edhe mungesa e teksteve fizike për literaturën bazë dhe të rekomanduar në bibliotekë, për programin e studimit.
3. Burimi kryesor i financimit të programit të studimit janë të ardhurat e siguruar nga tarifa e shkollimit që paguajnë studentët dhe donacionet e bursave të studimit.

Rekomandime:

1. Institucioni të angazhojë në zhvillimin e procesit mësimor personel akademik, minimumi të kategorisë "Lektor", me formim specifik në funksion të programit të studimit.
2. Institucioni të përditësojë literaturën e detyrueshme dhe specifike për të gjitha lëndët e programit të studimit dhe të vazhdojë pasurimi i literaturës fizike për lëndët e programit të studimit në përputhje me programet e azhuruara të lëndëve.
3. Institucioni të angazhohet për gjetjen e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit, përveç tarifave studentore;



4. Institucioni të garantojë që stafi akademik efektiv të mbulojë të paktën 70% te ngarkesës mësimore;
5. Institucioni të angazhohet në plotësimin e syllabuseve e lëndëve të programit të studimit, në rastet e munguara titullari i lëndës, si dhe të përcaktohen temat e detyrave/projekteve të kursit dhe të punëve laboratorike;
6. Institucioni të konsolidojë mjediset profesionale ku studentët kryejnë praktikat e nevojshme në lidhje me programin e studimit;
7. Institucioni të kryejë një studim të mirëfilltë të tregut të punës për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca kompjuterike", në mënyrë që të reflektojë përmirësimet e nevojshme që lidhen me zhvillimin dhe prirjet kombëtare dhe globale të zhvillimit;
8. Institucioni të angazhohet në zgjerimin e bashkëpunimeve aktuale, me universitete apo institucione kërkimore brenda dhe jashtë vendit, kjo në funksion të projekteve të kërkimit shkencor dhe në funksion të përfshirjes më të gjerë në projektet exchange dhe mobilitet të stafit dhe studentëve të programit të studimit.



Conclusions of the evaluation of the second cycle study program, Master of Science in "Computer Sciences" of the higher education institution University College "Beder".

Strengths and Affirmations:

1. Appropriate facilities and modern didactic infrastructure available to the study program provide the necessary contemporary space and conditions for the learning process.
2. The study program is designed in accordance with the development strategy of University College Bedër and the economic development of the country and meets the labor market needs, in accordance with the strategic goals of national economic development.
3. The institution has developed specific mechanisms for the professional support and qualification of academic staff.
4. Academic staff with experience in the education field and industry.
5. Functional electronic information management system in function of the internal administration of the institution, but also of all didactic activity.
6. The care for student is carried out in compliance with all contractual conditions.
7. The selection process for incoming students based on merit and assessment of merits with academic scholarships which increases the quality of incoming students.
8. High employment of this study program students.

Weaknesses:

1. In some courses is evidenced the engagement in the education process of academic personnel of category "Asistent Lector".
2. The mandatory literature of the study program, in some courses is not of the last 5 years. The lack of physical texts for basic and recommended literature in libraries for the study program.
3. The main source of funding for the study program is the income provided by the tuition fee paid by the students and the donations of the study scholarships.

Recommendations:

1. The institution should employ in the development of the education process academic personnel, minimum of the "Lecturer" category, with specific academic and professional background in function of the study program.
2. The institution updates the mandatory and specific literature for all courses of study program and continues to enrich the physical literature for the study program courses in accordance with updated courses program.
3. The institution should commit to finding other resources to finance the study program, in addition to study tariffs.



4. The institution should assure that effective academic personnel to cover at minimum 70 % of teaching load.
5. The institution should engage in completing the syllabuses of the subjects of the study program, in cases where the title of the subject is missing, as well as determine the topics of course tasks/projects and laboratory work.
6. The institution should consolidate professional environments, where students perform the necessary practices related to the study program.
7. The institution should carry out a suitable study of the labor market for the Master of Science study program in "Computer Science", in order to reflect the necessary improvements related to the development and national and global development trends.
8. The institution should engage in the expansion of current collaborations, with universities or research institutions inside and outside the country, this in function of scientific research projects and in function of wider involvement in exchange projects and mobility of staff and students of the study program.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS		
	Përbushjen plotësisht	Përbushjen kryesisht	Përbushjen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT		X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X
VLERËSIMI TËRËSOR			X